

RAPORT

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM, PËR PROGRAMIN E
STUDIMIT JOUNIVERSITAR, PROFESIONAL, PAS
ARSIMIT TË MESËM, ME KOHË TË PLOTË
NË ELEKTRONIKË**

OFRUAR NGA “KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS”

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:

Dr. Alketa Grepcka



(Korrik/2017)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e Studimit jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë në Elektronikë

| Tabela e të dhënave për programin e studimit | | |
|--|---|--|
| 1 | IAL Aplikues: | Kolegji Profesional i Tiranës |
| 2 | Departamenti që e ofron | Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit |
| 3 | Urdhëri/VKM i licencimit | Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 699, datë 26.08.2015 |
| | Urdhëri i riorganizimit | Leja e fillimit të aktivitetit: Urdhër Nr. 426, datë 06.11.2015 |
| 4 | Titulli i programit të studimit: | Program Studimi jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë, në Elektronikë |
| 5 | Cikli i studimit: | N/A Program studimi me karakter profesional |
| 6 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 Vite |
| 7 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 8 | Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): | Me kohë të plotë |
| 9 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha Shqipe |
| 10 | Programi ofrohet nga institucioni | Po |
| 11 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera | Jo |
| 12 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | Jo |
| 13 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | Jo |
| 14 | Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve | 5 |
| 15 | Aktivizimi i programit të studimit | 2015-2016 |
| 16 | Numri total i studentëve për program studimi | 56 studentë |

***) Emërtimi i programit të studimit sipas VKM është:** Program Studimi jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë në Elektronikë

Ligji i Arsimit të lartë nr 80/2015 në nenin 72, pika 1 shkruan: IAL mund të ofrojnë programe studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, [...] dhe në përfundim lëshohet respektivisht "Certifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimit të kryer

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

“Kolegji Profesional i Tiranës” si institucion i Arsimit të Lartë, me statusin Kolegji Profesional i Tiranës është një institucion që ofron programe studimi jouniversitare, profesionale, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë në këto drejtime: Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Elektronikë, Data Base dhe Web Design, Elektro-Mekanikë, Teknologji Automjetesh, Mekatronikë, Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi, Gjeodezi, Teknologji Ndertimi.

KPT ushtron aktivitetin e saj në bazë të lejes me nr.9113 Prot. date 06.11.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit bazuar në urdhërin nr.426 datë 06.11.2015 “Për Lejimin për Ushtrimin e Veprimtarisë Akademike në Përputhje me Liçensen e Dhënë Institucionit të Arsimit të Lartë Privat Kolegji Profesional i Tiranës, Tiranë”. Misioni i Kolegjit Profesional të Tiranës është të ofrojë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme që synojnë të ndihmojnë studentët të kenë sukses në gjetjen e mundësive të punësimit në një nivel të kënaqshëm të të ardhurave, ku kurset që ofrohen ndërtohen mbi parime praktike qëu pergjigjen kërkesave të punëdhënësve dhe në mënyrë të tillë që ti pergatisin studentët edhe për studime universitare. Ky program studimi pajis studentin me aftësitë për t’u specializuar brenda një kohe të shkurtër. Programi i studimit profesional jouniversitar 2 – vjeçar “Elektronike” për vitin akademik 2016-2017 ka të regjistruar 37 studentë ndërkohë që numri i personelit akademik efektiv me kohë të plotë rezulton në 12 për vitin akademik mësimor 2016-2017.

GRUPI I VLERESIMIT TE JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Dr.Alketa Grepcka

Gjatë vizitës në Institucion, Ekspertja e Vlerësimit të jashtëm u shoqërua nga Specialistja e SPVC, Znj Suela Kromidha

Më datë 24.08.2017, Institucioni paraqet nëpërmjet sistemit AMS përgjigjen mbi Draft RVJ. Ky draft është dërguar në KPT nëpërmjet sistemit më datë 18.08.2017 dhe me shkresë zyrtare me Nr 90/22 prot, datë 21.08.2017 “Dërgohen Draft rraportet e vlerësimit të jashtëm”. Institucioni nuk kishte asnjë vërejtje mbi Draft RVJ. Për këtë arsye ky Raport merr formën e tij përfundimtare.


1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit, mësimdhënia, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për programin e studimit (historiku, numri i punonjësve në vite, numri i studentëve në vite, vendi i Programit të studimit në kuadrin e kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Vizioni i KPT-së shprehet qartë në Strategjinë e Zhvillimit të Kolegjit Profesional të Tiranës 2015 – 2020 [dok 7 fq 2]. KPT në vizionin e saj “synon të jetë lider në ofrimin e arsimit profesional duke dhënë kontributin e tij në zhvillimin ekonomik të vendit, duke krijuar profesionistë të aftë në shërbim të shoqërisë dhe ekonomisë”.

Misioni i KPT shprehet qartë në statutin e institucionit [dok 6, neni 6, pika 1]. Misioni i Kolegjit Profesional të Tiranës është “të ofrojë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme që synojnë të ndihmojnë studentët të kenë sukses në gjetjen e mundësive të punësimit në një nivel të kënaqshëm të të ardhurave, ku kurset që ofrohen ndërtohen mbi parime praktike qëu pergjigjen kërkesave të punëdhënësve dhe në mënyrë të tillë që ti pergatisin studentët edhe për studime universitare. Ky program studimi pajis studentin me aftësitë për t’u specializuar brenda një kohe të shkurtër”. Ky mision është edhe baza e ndërtimit të strategjisë së zhvillimit për Kolegjin Profesional të Tiranës 2015-2020 [dok 7 fq 3-4] në të cilin ky mision synon që:



- KPT të jetë një ndër ofruesit më të rëndësishëm të arsimit profesional në vend i cili do të jetë një urë lidhëse midis edukimit akademik dhe trajnimit profesional, duke i ndihmuar studentët në integrimin sa më të lehtë në tregun e punës.
- Të jenë një qendër ku profesionistët e rinj të vendit të njihen me inovacionet që bëjnë pjesë në programet e studimit të ofruara nga KPT
- Të sigurojë një bazë të mjaftueshme njohurish për të mundësuar transferimin e studimeve në nivele më të larta universitare.
- Të pajisë studentët me aftësi teorike dhe raktike, për t'i bërë ata të aftë të përballen me sfidat në rritje të tregut të punës, nërpermjet përshtatjes së kurrikulave drejt nevojave reale të industrisë.

Objektivat e KPT-se janë të shprehura qartë në Statutin e institucionit [dok 6, neni 6, pika 2]. Ky institucion ka si objektiv:

- a. Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, praktikave profesionale dhe shërbimeve;
- b. Të ndihmojë zhvillimin ekonomik dhe social në nivel kombëtar dhe rajonal, duke përgatitur specialistë të aftë për të kaluar brenda një kohe të shkurtër në tregun e punës, në profesione që kërkojnë kualifikim dhe trajnim profesional dhe jouniversitar e që njëkohësisht sigurojnë një nivel mesatar dhe të lartë të ardhurash;
- c. Të kontribuojë në rritjen e formimit profesional të rinisë shqiptare, duke ofruar kualifikim cilësor dhe në përputhje me kërkesat e tregut;
- d. Të ofrojë programe studimi që nderthurin formimin e nevojshëm akademik me atë profesional, me qëllim që studenti i diplomuar të ketë mundësi të kalojë në tregun e punës ose të thellojë studimet që programet universitare të ciklit të parë tëstudimeve;
- e. Të kryejë studime, trajnime dhe kërkime në fushat e licënsuara;

Në Strategjinë e Zhvillimit të Kolegjit Profesional të Tiranës 2015-2020 misioni i KPT-së është zbërthyer në objektiva strategjike të cilat në terma afatgjate synojnë tre kolona të rëndësishme përkatesisht veprimtarinë arsimore, veprimtarinë zhvilluese dhe veprimtarinë kërkimore [dok 7, fq5-8].

KPT ka një synim të qartë që shprehet edhe në Strategjinë Zhvillimit të KPT-s 2015-2020 përmes prioriteteve strategjike [dok 7, fq 3-4] që konsistojnë në:

- a. Të qenurit një institucion inovativ në mënyrën e të mësuarit apo të ofrimit të programeve të reja të studimit, bazuar dhe në kërkesat e tregut.
- b. Orientimi drejt praktikës profesionale duke synuar përgatitjen e teknikëve të lartë.
- c. Ofrimi i një stafi cilësor akademik të përbërë nga pedagogë e profesionistë, të aftë dhe me përvojë të kombinuar me aftësi teorike dhe praktike.
- d. Infrastruktura. Krijimi i ambjenteve optimale të studimit si për mësimin teorik ashtu edhe për atë praktik;
- e. Marrëdhëniet ndërkombëtare. KPT synon të shndërrohet në një qendër të risive teknologjike duke u bazuar dhe në krijimin e raporteve të ngushta bashkëpunuese me institucionet e ngjashme në rajon dhe më gjerë.
- f. Bashkëpunimi me bizneset dhe krijimi i një raporti optimal, duke synuar një punësim të sigurtë për studentët ende pa mbaruar studimet. Ky bashkëpunim është pjesë e strategjisë së angazhimit me punëdhënësit.
- g. Fokusimi tek studentët. Përmëshja e nevojave të studentëve nëpërmjet krijimit të një ambjenti arsimor të përshtatshëm, ku studentët të arrijnë qëllimet e tyre duke ju ofruar një gamë e gjerë të mundësive për arsimin profesional, e cila do t'i ndihmojë ata të shfrytëzojnë më së miri potencialin e tyre.



- h. Të mesuarit gjatë jetës.
- i. Krijimin e një qëndrueshmërie financiare e institucionale të Kolegjit, nëpërmjet menaxhimit efektiv, për të qenë të aftë për të përballuar sfidat e të ardhmes.

Për arritjen e prioriteve strategjike, Kolegji Profesional synon që deri në vfund të vitit 2020 të jetë zgjeruar në mënyrë horizontale, vertikale, sasiore dhe cilësore.

Zgjerimi horizontal synon në ofrimin e 12 programe studimi (specialitete) si në sistemet elektrike, gazi, druri, struktura metalike, programe të cilat janë në përputhje me prioritetet e zhvillimit kombëtar dhe rajonal. Tashme ofrohen 8 programe studimi dhe deri në fund të 2020 synohet në hapjen e 4 programeve të reja studimi. Vertikalisht KPT synon të ofrojë studime të ndryshme 1 vjeçar ose 3 vjeçar për secilin specialitet. Ana sasiore konsiston në shtimin e numrit të studentëve që në fillim të vitit 2020 të jenë 500-600 studentë dhe nga ana cilësore duke përshtatur kurrikulat me ndryshimet teknologjike

Vlerësimi sipas standardeve

| Standardi 1: Aftësitë specifike të lidhura me sektorin e punësimit janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë zhvillimit të programit të studimit |
|--|
| <p>Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:</p> <p>Kriteri 1 Punësimi është trajtuar në hartimin e kurrikulave, në karrierën arsimimin, informimin dhe udhëzimet.</p> <p>Kriteri 2 Punësimi është një çështje kyçe për miratimin e programit, monitorimin dhe rishikimin e tij.</p> <p>Kriteri 3 Studentëve i është dhënë mbështetje për zhvillimin e aftësive në funksion të punësimit..</p> <p>Kriteri 4 Programi parashikon dhe kredite të përfituara gjatë punës</p> <p>Kriteri 5 Të përfshijnë inisiativa specifike si psh. mbështetje për sipërmarrjen</p> <p>Kriteri 6 Krijimi i lidhjeve punëdhënës / IAL.</p> |
| <p>Vlerësimi sipas standardit 1:</p> <p>Kriteri 1 & 2: Për hartimin e programit të Elektronikës është bërë një punë në drejtim të hartimit të kurrikulave që këto të përshtaten me kërkesat e tregut të punës dhe nevojës së tij për specialistë në fushën e elektronikës. Për hartimin e tyre është marrë mendimi i shumë ekspertëve, përputhja me kërkesat e MAS dhe kriterëve të sigurimit të cilësisë së brendshme të përcaktuara nga APAAL [RVB, dok 7 fq 5-8]. Për hartimin e kurrikulave është marrë edhe eksperiencia nga Gjermania, kryesisht shkolla të ngjashme në zonën e Larisë etj. Programi studimit është i bazuar në marrjen e njohurive teorike dhe një fokus i veçantë i jepet praktikës me qëllimin në aftësimin sa më profesional të studentëve dhe punësimin sa më të shpejtë të tyre në tregun e punës [RVB, takim me shefi e departamentit, takim me stafin akademik]. Me miratimin e programit të studimit një punë e veçantë është bërë në drejtim të hartimit të syllabuseve. Syllabuset janë në një proces të vazhdueshëm përmirësimi. Stafi akademik theksoi punën që bëhet në lidhje me përshtatjen e tyre sipas nivelit të studentëve dhe kërkesave të tregut të punës. Në përmirësimin e programit janë bërë konsultime me kolegë të Universitetit Politeknik të Tiranës të cilët mbartin eksperiencë në këtë fushë, kryeinxhinierë që punojnë në kompani të njohura si Deutch Telekom, ABCOM. Konsultime janë bërë me profesorë në Larisa\Greqi në lidhje me përzgjedhjen e pajisjeve elektronike laboratorike si edhe manualet e përdorimit të tyre të cilat janë përkthyer nga stafi akademik dhe pasqyrohen në orët laboratorike dhe teorike [takim me stafin akademik].</p> <p>Kriteri 3: Studentëve u jepet përparësi në përthithjen e njohurive teorike dhe praktike. Nje fokus i veçantë i jepet pjesëmarrjes në orët laboratorike ku një temë trajtohet në 3 orë laborator dhe punohet veçantë ditën e shtunë dhe të djelë për studentë që paraqesin vështirësi [tak me prof të laboratorit të elektronikës]. Pjesëmarrja në punën laboratorike është 80% e detyrueshme por synohet të bëhet 100% [dok. 17, tak me stafin akademik].</p> <p>Kriteri 4: Në aftësimin e studentëve praktika profesionale luan një rol të rëndësishëm. Aktualisht ajo vlerësohet me 7 kredite, por takimi me rektorin nxorri në pah synimin e institucionit për vlerësimin e saj me 10 kredite [tak me rektorin].</p> <p>Kriteri 5&6: Njohjet nga stafi, pedagogët e jashtëm janë burime që shërbejnë për krijimin e urave të bashkepunimit të KPT-së me kompani të njohura të biznesit dhe punësimit të studentëve pas diplomit të tyre. KPT është në fillimet e saj dhe nuk ka krijuar një qendër të karrierës por rolin e saj e luan Njësia e Informimit</p> |

dhe Mbështetjes së Studentëve që mundëson informimin e studentëve në lidhje me ushtrimin e praktikave profesionale dhe oferta punësimi [tak me rektorin]. Bashkëpunohet me UPT, Universiteti Europian i Tiranës, Universitetin "Aleksander Moisiu" Durrës [dok 18-Marrëveshjet me IAL-të].

Konkluzionet e GVJ:

Evidentoj që aftësitë specifike të lidhura me sektorin e punësimit janë tashme të krijuara dhe janë në proces të zhvillimit dhe vlerësimit gjatë gjithë zhvillimit të programit të studimit. Duhet të theksoj që eskperienca në këtë fushë është e re meqenese institucioni tashmë ka dy vjet që zhvillon veprimtarinë e tij. Evidentoj një punë serioze në hartimin e syllabuseve për programin "Elektronikë" dhe ajo që është më e rëndësishme përmirësimi i vazhdueshëm i tij në lidhje me përshtatjen sipas kërkesave të tregut. Marrja e mendimit nga ekspertë, shfrytëzimi i eksperiencës së stafit akademik dhe sidomos të stafit akademik me kohe të pjesshme janë disa burime që tregojnë një punë serioze në këtë drejtim. Bazuar më sipër e konsideroj këtë standard të përmbushur.

2. Struktura akademike e Njesisë Bazë (përgjegjëse për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për personelin akademik në njësinë bazë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ, koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera të institucionit.

Kolegji Profesional i Tiranës përbëhet nga dy departamente përkatësisht Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara [dok 6 neni 13, dok. 11 Kreu II, neni 4]. Programi i studimit "Elektronikë" zhvillohet në Departamentin e Teknologjisë dhe Informacionit i cili është pjesë e strukturës së përgjithshme të KPT-së dhe është një nga njësitë bazë mësimore dhe kërkimore. Struktura e organizimit të Departamentit të Teknologjisë dhe Informacionit përfshin përgjegjësin e departamentit i cili ka në varësinë e tij përgjegjësit e Laboratorit të Elektronikës, Laboratori i Teknologjisë së Informacionit dhe Laboratorin e Instalimeve Elektrike [RVB fq 6, vizita]. Përgjegjësi i departamentit është pjesë e Senatit Akademik dhe detyrat e përgjegjësitë e tij janë të përcaktuara qartë në Statutin e KPT-së [dok.6 neni 23]. Në funksion të departamentit janë stafi ndihmës, njësitë bazë ndihmëse si laboratorit i informatikës, libraria, NJSBC, biblioteka etj [dok. 6, neni 14]. Programi i studimit "Elektronikë" zhvillon një kuadër baze teorik të përshtatshëm për studentët i cili mbështetet nga një program i gjerë praktik përmes zhvillimit të orëve laboratorike në tre laboratore përkatësisht Laboratorit të Elektronikës, Laboratori i Teknologjisë së Informacionit dhe Laboratorin e Instalimeve Elektrike si edhe në subjekte pritëse sipas marrëveshjeve institucionale të lidhura.

Tregues të matshëm:

- Struktura didaktike (Departamenti/sektorët) për programin e studimit

Rektori është autoriteti më i lartë akademik i KPT-së. Detyrat e tij janë të përcaktuara në Statutin e KPT-së si edhe në aktet e tjera rregullatore të institucionit. Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit ofron programet e studimit [dok. 11, pika 4.2]:

1. Teknologji informacioni dhe Komunikimi;
2. Elektronikë
3. Database dhe Eëbdesign.

Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit drejtohet nga shefi i departamentit kompetencat e të cilit përcaktohen në Statutin dhe Rregulloren e Institucionit. Varësia institucionale jepet përmes organigramës së KPT [dok. 9] dhe organigramës së departamentit [RVB fq.6].



- Numri i personelit akademik në Departament: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), titujt/gradat, (plotëso Tabelën 1, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 1

| Viti akademik | Stafi akademik i Departamentit | | | |
|-----------------|--------------------------------|-------------|-------------------------|------------------------------|
| | Numri i PAE | Numri i PAK | Numri i Stafit të ftuar | Numri i Stafit administrativ |
| Psh 2015 - 2016 | 8 | 4 | - | 5 |
| 2016 - 2017 | 12 | 12 | - | 5 |

- Shih Statutin e Institucionit (Aneksi 6)
- Shih Rregulloren e Institucionit (Aneksi 11)
- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës

Nuk ka dokumentacion të marrë gjatë vizitës

3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për Programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Në programin e studimit “Elektronikë” angazhohet një staf i kualifikuar. Numri i stafit ka patur ngritje në krahasim me vitin akademik 2015-2016. Aktualisht janë të angazhuar 12 pedagogë ku 3 prej tyre zotërojnë gradën profesor ndersa 9 jane pa grada shkencore. Bazuar në Statutin e KPT-së personeli akademik I angazhuar në mësimdhënie duhet të ketë të paktën gradën Master Profesional [dok.6, Kreu IV, neni 30, pika 2]. Përzgjedhja e stafit behet mbi bazën e kualifikimeve akademike dhe eksperiencës së mbartur. Ky kriter është si për punësimin e stafit me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Personeli punësohet sipas formave të parashikuara në Statut dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore të aplikueshme. Kontrata e punës që lidhet midis KPT-së dhe stafit akademik mbështetet në Ligjin nr.9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në Kodin e Punës [vizitë në zyrën e Burimeve Njerëzore, dok.6 neni 29, pika 2].

Për vitin akademik 2016-2017 janë angazhuar 12 pedagogë me kohë të pjesshme ku 1 është me gradën Prof.Asc., 4 janë me gradën Doktor i Shkencave dhe 7 me gradën Master i Shkencave ose Master Profesional. Personeli akademik me kohë të plotë është me kontrate me afat ose pa afat, dhe përbëhet nga drejtuesi i departamentit dhe personeli akademik efektiv. Personeli akademik i punësuar me kohë të pjesshme përbëhet nga personeli akademik i jashtëm dhe lektorët e ftuar [vizitë në zyrën e Burimeve Njerëzore, dok.6 neni 30, pika 2]. Personeli akademik përzgjidhet me konkurs pas shqyrtimit nga një Komision Rekrutimi i cili përbëhet nga Rektori, Administratori, Përgjegjësi i Departamentit, Përgjegjësi i Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe nëse është e pershtatshme kërkohet dhe merr pjesë edhe një përfaqësues i stafit akademik i cili kryesisht është përfaqësues i grupit mësimor brenda departamentit të TI-së [dok 6 neni 30 pika 3, vizitë në zyrën e burimeve njerëzore, takim me stafin akademik]. Vendimin për punësimin e stafit akademik e ka Rektori. Përzgjedhja e stafit akademik bëhet mbi bazën e manualit të përgatitur nga zyra e burimeve njerëzore. Kjo zyrë mbledh CV dhe letrat e motivimit të stafit akademik dhe pas një përzgjedhje paraqet kandidaturat që plotësojnë kriteret. Këto kandidatura i nënshtrohen më pas procesit të intervistës ku Komisioni i Rekrutimit bën edhe përzgjedhjen e kandidaturës më të mirë. Ndër kriteret kryesore të përzgjedhjes vlen të përmendet eksperiencia në mësimdhënie në nivel universitar, zoterimi i një diplome të paktën në Master Profesional. Prioritet i jepet cilesisë dhe standartit të universitetit ku është diplomuar kandidati duke i dhënë përparësi universiteteve të huaja dhe kryesisht perëndimore, rezultatet personale të kandidatit, paraqitja përpara komisionit dhe gjatë leksionit të hapur para departamentit përkatës (kur aplikohet) [takim me zyrën e burimeve njerëzore, takim me stafin

akademik, RVB FQ 9, dok.6, manual I ZBNJ]. Rekrutimi për stafin me kohë të pjesshme bëhet mbi bazën e marrëveshjes institucionale të lidhur midis universitetit përkates dhe KPT. Procesi i rekrutimit të stafit akademik bëhet kryesisht në periudhën Gusht – Shtator por kërkesat për staf akademik vijnë nga departamenti i TI, kërkesa të cilat depozitohen në zyrën e burimeve njerëzore përgjatë gjithë vitit. Nuk kanë patur largime të stafit akademik për shkelje të rregullores apo të Kodit të Etikës. Evidentohet vetëm një rast largimi (Alfred Hasanaj) për shkaqe personale. Në vizitën e bërë në zyrën e burimeve njerëzore në mënyrë rastore u bë edhe kontrolli për dokumentacion në lidhje me një staf akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Rezultojnë dokumentacionet si më poshtë vijojnë:

Prof. Dr. Shpëtim Bozo (staf akademik me kohë të plotë):

- a. Librezë pune
- b. Librezë shëndetësore
- c. Fotokopje kartë identiteti
- d. Diploma
- e. Dëshmi profesionale
- f. Bibliografi
- g. Kontratë punësimi pa afat filluar me datë 04.10.2016.

Marsida Ibro (staf akademik me kohë të pjesshme):

- a. Leje angazhimi midis KPT dhe UAMD
- b. Fotokopje kartë identiteti
- c. CV
- d. Diploma
- e. Kontratë pune me afat semestral
- f. Librezë shëndetësore
- g. Librezë pune

Kundrejt stafit akademik me kohë të plotë KPT ndjek politikën e nxitjes së perfundimit të studimeve për pedagogët e rinj në proces doktorature. Në lidhje me aftësimin profesional një fokus i veçantë iu është dhënë trajnimit të stafit të anagzhuar në laboratore. Duke u bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit me shoqërinë Polytech S.A për blerjen e pajisjeve laboratorike, janë zhvilluar edhe trajnime të stafit akademik nga ana e shoqërisë Polytech S.A [dok. 23].

Tregues të matshëm:

- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit (plotëso Tabelën 2, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)**

Tabela 2

| IAL : Kolegji Profesional i Tiranës | | | | Departamenti: Teknologji Informatik | | | |
|-------------------------------------|----------------|----------------------------|-------------------|-------------------------------------|----------------------|-------------------|--------------------------------------|
| PAE (Emër Mbiemër) | | Detyra në Dep. | Titulli /Grada | PAK (Emër Mbiemër) | | Titulli /Grada | Institucioni ku punon full time |
| 1 | Luan Karçanaj | Rektor | Prof. Dr. | 1 | Elson Agastra | Prof.Asc. | Universiteti Politeknik i Tiranës |
| 2 | Piro Cipo | Përgjegjes Departamenti | Prof. Dr. | 2 | Ilir Shinko | Dr. | Universiteti Politeknik i Tiranës |
| 3 | Shpetim Bozdo | Pedagog | Prof. Dr. | 3 | Alban Rakipi | Dr. | Universiteti Politeknik i Tiranës |
| 4 | Saimir Yzeiri | Pedagog | MP | 4 | Renalda Kushe | Dr. | Universiteti Politeknik i Tiranës |
| 5 | Petro Plasa | Pedagog | MND | 5 | Blerta Leka | Dr. | Universiteti Bujqësor i Tiranës |
| 6 | Engjell Çiraku | Pedagog | MSc | 6 | Nevila Xoxa | MSc. | Akademia Shkencave, Tiranë |
| 7 | Dritan Karriqi | Pedagog | MSc | 7 | Andi Zeneli | MSc. | "ONA" shpk |
| 8 | Thimi Oço | Pedagog | MSc | 8 | HatixhE Bilibashi | MSc. | "Protic ICT", Tiranë |
| 9 | Ervin Suli | Pedagog | MSc | 9 | Viola Civici | MSc. | Nuk është e punësuar |

| | | | | | | | |
|----|--------------|---------|-----|----|----------------|------|--|
| 10 | Besnik Sadaj | Pedagog | MSc | 10 | Marsida Ibro | MSc. | Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës |
| 11 | Erjon Curraj | Pedagog | MSc | 11 | Greta Shehu | MP | "Deloitte", Albania |
| 12 | Fatos Backa | Pedagog | MSc | 12 | Algert Ismalaj | MSc. | headHunter shpk, Tiranë |

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (plotëso Tabelën 3, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)**

Tabela 3

| Titulli | Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit | | |
|-------------------------|---|-----|-----------------|
| | PAE | PAK | Raporti PAE/PAK |
| Profesorë | 3 | 0 | 3/0 |
| Profesorë të As. | 0 | 1 | 0/1 |
| Doktorë | 0 | 4 | 0/4 |
| Pedagogë (pa tituj) | 9 | 7 | 9/7 |
| Asistentë me Ma | - | - | - |
| Asistentë pa Ma | - | - | - |
| Instrukturë praktike | - | - | - |
| Personeli Administrativ | 5 | - | - |

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

Personeli punësohet sipas formave të parashikuara në Statut dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore të aplikueshme. Kontrata e punës që lidhet midis KPT-së dhe stafit akademik mbështetet në Ligjin nr.9741, date 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe në Kodin e Punës [vizitë në zyrën e Burimeve Njerëzore, dok.6 neni 29, pika 2]. Në vizitën e bërë në zyrën e burimeve njerëzore, nga verifikimi i bërë u evidentua që kontrata përmban nene të cilat përcaktojnë qartë detyrat e punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe gjithashtu të drejtat e stafit akademik janë të sanksionuara në Statut, Rregulloren e Departamentit të Teknologjisë dhe Informacionit [dok.6, dok.24, aneksi 10- kontrata individuale e punës]. Kontrata e punës që nënshkruhet për stafin akademik efektiv është pa afat, ndërsa për personelin akademik me kontratë afati i punësimit është semestrale.

- Ngarkesa semestrale, vjetore etj**

Përgatitja dhe shpërndarja e ngarkesës semestrale dhe vjetore është detyrë e shefit të departamentit të Teknologjisë dhe Informacionit. Ky i fundit bën edhe shpërndarjen e tij në stafin akademik efektiv dhe propozon pranë burimeve njerëzore kërkesën për staf akademik me kohë të pjesshme. Ngarkesa mësimore e personelit akademik dhe format e saj sanksionohen në Statutin e KPT-së, Rregulloren e Departamentit të TI-së, në Kodin e Punës dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi [dok. 6, dok. 24, aneksi 10 – kontrata individuale e punës]. Lëndët mbulohen nga staf akademik i brendshëm dhe stafi akademik me kohë të pjesshme. Aktualisht angazhohen 12 si PAE ku 3 janë me graden Prof., 9 me MSc dhe 12 si PAE ku 1 është me graden Prof. Asc., 4 Dr dhe 7 me MSc.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi 2 Aftësi të transferueshme janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Punëdhënësit ndihmojnë në përcaktimin e përvojave thelbësore (p.sh. përvoja e punës) dhe aftësitë ndër-kurrikulare, qëndrimet dhe njohuritë (p.sh. të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, komunikimi, TIK, marrëdhëniet me klientët)

Kriteri 2 Çdo aftësi është ndjekur përmes moduleve (Përmbajtja e kursit, metodat e mësimdhënies, vlerësimit) në fazat e zhvillimit të kurrikulës dhe nëpërmjet rishikimit të programit.

Kriteri 3 Rezultatet janë të monitoruara (p.sh. punësimi i të diplomuarve).



Vlerësimi sipas standardit 2:

Aftësitë e studentit evidentohen qartë nga ana e Kolegjit Profesional Privat “Kolegji Profesional i Tiranës” gjatë fazës së implementit të programit të studimit. Shpjegimi i detajuar i kurrikulave të programit “Elektronikë”, përmbajtjes, detyrimet e studentit gjatë periudhës së studimit të tij, mënyra e organizimit të mësimdhënies (% e shprehur për anën teorike, seminare, laboratore), dhe praktika profesionale si edhe e drejta nga ana e përgjegjesit të departamentit për të rishikuar dhe përmirësuar këtë program janë të shprehura në përputhje me objektivat e këtij institucioni.

Syllabuset janë të ndërtuara qartë dhe shprehin raportin e kuadrit teorik me atë të praktikës në laboratorë. Në varësi edhe të lëndës praktika në laboratorë realizohet në ambjentet e KPT ose në subjektet pritëse për të cilat KPT ka nënshkruar edhe marrëveshje institucionale. Objektivat në syllabuse janë në përputhje edhe me objektivat afatgjatë të KPT të shprehur në Statutin dhe në Strategjinë e Zhvillimit të këtij institucioni. Në të gjithë lëndët prezencën në veprimtaritë mësimore në auditor është e detyrueshme në masën 60% për ushtrime/leksione dhe në masën 80% për laboratore/praktika. Në syllabuse shprehet edhe ndërvarësia e lëndës me lëndët e tjera semestrale ose në vijim. Jepet gjithashtu qartë literatura e detyruar dhe literatura bazë. Evidentova që 55% e lëndëve kanë si literaturë bazë leksione të shkruara, 30% libra të cilat shumica nuk janë të vetë stafit akademik që ofron lëndën përkatëse, 10% përmbajnë literaturë të huaj si të detyruar dhe 5% përkatësisht lënda praktika profesionale ka në literaturën e detyruar shpjegimet e profesorit [dok. 17]. Nga takimi me shefin e departamentit të TI dhe me stafin akademik u theksua puna që do të bëhet në lidhje me rritjen e numrit të leksioneve të shkruara dhe ndërtimin e udhëzuesve për punët laboratorike. Leksionet janë të botuara edhe on-line dhe në syllabuse shprehen edhe të dhënat për sigurimin e kontakteve. Vlerësimet e punëve laboratorike/ praktika janë 7 kreditë dhe një vëmendje e veçantë i jepet cilësisë së tyre. Mendohet që në vitin e ardhshëm pjesëmarrja e detyruar në praktika/laborator të bëhet nga 80% në 100%. 12 studentë marrin pjesë në orë laboratorike dhe ky raport është pothuaj i njëjtë me Universitetin Politeknik ose me vende të huaja (shembull u sollën me Kroacine, Greqine etj) **[tak me shefin e TI]**. Në Strategjinë e Zhvillimit të programit “Elektronikë” parashikohet rritje e numrit të stafit kryesisht në udhëheqjen e punëve laboratorike. Një mbështetje i është kërkuar për vitin akademik 2017-2018 për investime në zhvillimin e modelit fizik. Në lidhje me simulimin virtual Universiteti i Larises ka sjellë softe të çertifikuara si MATLAB, LABVIEW të cilat janë edhe të licensuara. Ngarkesa e stafit akademik është 350 orë faktike për punë laboratorike.

Zhvillimi i praktikave profesionale në kompani private përbën një bazë për marrjen e eksperiencave më të mira, për zhvillimin e një analize dhe mendimi kritik në lidhje me shumë procese të hasura në praktikë. Praktikave profesionale janë të shprehura edhe në rregulloren përkatëse **[dok. 8]**. Praktika profesionale ndiqet nga shefi i TI në bashkëpunimin me Njësinë e Informimit dhe Mbështetjes së Studentit **[dok. 7 neni 3, pika 1]**. Praktika profesionale organizohet në semestrin e II të vitit të II dhe përmban 147 orë detyruese zhvillimi në subjektin pritës i cili përcaktohet nga KPT ose zgjidhet nga vetë studenti. Shembuj u sollën për zhvillimin e praktikave profesionale në Albania Mobile, Deutch Telecom, Abcom dhe në kompani të tjera që operojnë në fushën e instalimeve në fushën e automatizimit dhe elektronikës, në ambjentet e banesave, në kompani që riparojnë dhe shesin pajisje elektronike, në kompani që furnizojnë shërbime të komunikimeve elektronike, të shërbimeve të transmetimeve dhe ritransmetimeve audio dhe audiovizive **[takim me shefin e TI, takim me stafin akademik, takim me studentet, dok.8 neni 7 pika 2]**. Në fund studentit i përgatit një raport i cili mbrohet para një komisioni dhe bëhet vlerësimi përkatës i tij.

Studenti mund të zhvillojë praktikë profesionale edhe në ambjentet e KPT në dy laboratorë të veçantë që zoteron departamenti. Në zhvillimin e vizitës, u evidentua rasti i 4 studentëve që kishin zhvilluar



praktikën profesionale në keto ambiente kryesisht me tematikën në riparimin dhe formatimin e aparateve elektronike nën supervizionin e stafit akademik të brendshëm.

Në lidhje me rezultatet e monitorimit të numrit të punësuarve pas diplomimit, Kolegji Profesional Privat duhet të vendosë edhe strukturën e menaxhimit të karrierës studentore të cilën për momentin mbulohet nga Njësia e Informimit dhe Mbështetjes së Studentit [tak me rek p.5, tak me stafin akademik, tak me shefin e departamentit të TI, takim me studentet, dok.17, dok. 10].

Standardi 5: Stafi zotëron aftësi, sjellje dhe përvojë të duhur për rezultatet e pritshme të programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Të dhëna nga specialistë të sektorit përkatës të punësimit

Kriteri 2 Stafi mësimdhënës angazhohet në përditësimin e mëtejshëm, specifikisht për anën profesionale, lëndët dhe vendet e punës

Kriteri 3 Janë ngritur sisteme për evidentimin e hershëm dhe ofrimin e mbështetjes, për mbështetjen e të mësuarit tek studentët

Kriteri 4 Stafi ka siguruar mbështetje për studentët me kohë të pjesshme (part time), p.sh. nëpërmjet email-it, ofrimit të të mësuarit virtual dhe ambienteve përkatëse (e-learning).

Vlerësimi sipas standardit 5:

Në lidhje me rezultatet e monitorimit të numrit të punësuarve pas diplomimit, Kolegji Profesional i Tiranës duhet të vendosë edhe strukturën e menaxhimit të karrierës studentore të cilën për momentin mbulohet nga Njësia e Informimit dhe Mbështetjes së Studentit. Në lidhje me punësimin e studentëve mundësohen lidhjet e stafit akademik me kompanitë e biznesit, shfrytëzohet informacioni që stafi PAE sjell në institucion dhe praktikën që studentët zhvillojnë në kompanitë e biznesit.

Kurrikulat janë në një proces të vazhdueshëm përmirësimi. Ndryshime në lëndë bëhen në masën 30%. Në procesin e përmirësimit merret mendimi nga kolegë të Universitetit Politeknik, nga kompani të biznesit si Deutch Telecom, ABCom me të cilët janë bërë konsultime në lidhje me përmirësimin e programit. Konsultime janë bërë edhe me profesorë të Universitetit të Larises/Greqi për gamën e pajisjeve elektronike dhe për përkthimin e manualeve të cilat janë pasqyruar në ndërtimin e udhëzuesve laboratorike dhe një pjese edhe në kuadrin teorik.

Përmirësimi i programit mësimor bëhet edhe nga stafi akademik PAK. Këto sjellin eksperiencën e tyre dhe shembuj u sollën për eksperiencën nga projekte të Akademisë së Shkencës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ku në këtë të fundit studentët kanë qenë pjesë e projektit dhe është zhvilluar mësimi i hapur në lidhje me Printerat 2D-3D.

Për mbështetjen e studentëve zhvillohet edhe procesi i tutorit. Cdo vit përcaktohet edhe stafi që do të jetë tutor i cili ofron mbështetje të studentëve në vështirësi. **Tutoriati i studentëve kontrollohet nga shefi i departamentit të TI dhe nga NJBSC. Një herë në javë 1 pedagog për 1 grup mësimor mbledh informacion për studentët në ngarkim.**

Konkluzionet e GVJ:

Bazuar në evidencat e marra [dok.7, dok.8,dok. 17, dok.23], takimi me rektorin, shefin e departamentit të TI-së, takim me stafin akademik dhe me studentët eidentoj që programi mësimor "ELEKTRONIKË" është i ndërtuar mbi një bazë solide mësimore, i cili ofrohet nga një staf i specializuar dhe i motivuar. Syllabuset janë të ndërtuara qartë dhe shprehin objektivat përkatëse të lëndës në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të këtij departamenti dhe institucionit në tërësi. Praktikën laboratorike dhe profesionale zënë një vend të rëndësishëm dhe sigurojnë një kualifikim profesional të studentëve në fund të studimit të tyre. Mendoj se tashmë institucioni duhet të punojë për ndërtimin e strukturs së menaxhimit të karrierës duke konsideruar që për vitin akademik 2017-2018 mendohet një rritje të numrit të studentëve nga 55 që janë aktualisht në 500 për vitin akadmik 2017-2018. Ky standard konsiderohet i përmbushur.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkimore

Godinat e Kolegjit Profesional të Tiranës janë të vendosur pranë kompleksit të ndërtesave të quajtur "Kompleksi Xhura" në një zonë totale prej 14,000 m² që në vetvete është i përbërë nga 12 godina. Hapesira e marrë me qera nga KPT shpk në bazë të kontratës së Qirasë, përfshin një sipërfaqje prej 2,500 m² të përdorimit akademik duke marrë parasysh që:

KPT ka marrë me qera katin e parë dhe katin e IV në objektin referuar Godina nr.2. Kati i parë ka një sipërfaqje prej 1,020 m², ndërsa kati i katërt ka një sipërfaqje prej 1,200 m². Kjo hapësirë është përdorur për klasa, laboratorë dhe zyra të sekretarisë dhe zyrat përkatëse të stafit akademik. Një sipërfaqje prej 280m² gjendet në Godinen 1C (kati përdhe). Kjo hapësirë përdoret për laboratorë/ oficina. Ambjentet janë të rrethuar me një hapësirë të gjelbërt dhe vend parkimi. Hapësira e sallave mësimore (leksione/ laboratorë), stafit akademik dhe të gjithë ambjentet ndihmëse janë të pajisura me një sistem HVAC, ndricimi i mjaftueshëm, izolim të sigurt nga zhurmat dhe sigurimi i një akustike të duhur. Klasat për zhvillimin e leksioneve me kapacitet deri në 80 studentë janë të pajisura me projektorë të varur, ndërsa sallat për praktika/ ushtrime kanë një kapacitet për 30-35 studentë dhe së bashku me sallat e leksioneve janë të vendosur pranë laboratorëve në ambjentet e katit të katërt.

Të gjitha objektet janë të pajisura me mjete mbrojtëse kundër shkarkimeve elektrike (4 rrufepritëse) dhe pajisje të mbrojtjes nga zjarri që u evidntua në sallat laboratorike, në korridore të katit të parë dhe të katërt. Ambjentet janë të pajisur me dedektorë me ndjeshmëri të lartë kundra zjarrit të cilat janë të vendosur në tavanet e ambjenteve.

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Tregues të matshëm:

- Mjediset e institucionit në funksion të programit të studimit (plotëso Tabelën 4, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

| Mjediset për Kolegjin (për programin e studimit) | Sasia | Sipërfaqja |
|--|--------------------------|----------------------|
| Salla për leksione | 4 | 422m ² |
| Klasa për seminare | 5 | 224.5m ² |
| Salla për aktivitete promovuese | 0 | 0 |
| Salla për praktikë lëndore/ profesionale | 4 | 283.3m ² |
| Laboratorë për lëndët | 5 | 287.7m ² |
| Laboratorë informatike | 2 | 111.7m ² |
| Salla interneti | 1 | 69m ² |
| Salla për bibliotekë | 1 | 89.6m ² |
| Mjedis për fotokopjime, librari etj | 1 | 27.4m ² |
| Zyrë informacioni për studentët | 1 | 18.5m ² |
| Korridore/holle | | 441.9m ² |
| Mjedise sportive | 0 | 0 |
| Mjedise shërbimi për të tretë | 0 | 0 |
| Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore | 0 | 0 |
| Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj | 0 | 0 |
| Nyje hidrosanitare për studentët | 5 | 109m ² |
| shkalle | | 122.3 m ² |
| Norma m²/për student | 6.49m² | |



| Mjediset për stafin: | Sasia | Sipërfaqja |
|--|---------------------------|----------------------|
| Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore | 0 | 0 |
| Zyra për personelin akademik | 6 | 155.4 m ² |
| Zyrë për financën | 1 | 10 m ² |
| Zyrë për Njësinë e SBC | 1 | 18.5 m ² |
| Salla për mbledhje | 0 | 0 |
| Mjedis për stafin e shërbimit | 3 | 73 m ² |
| Nyje hidrosanitare për personelin akademik | 1 | 22.2 m ² |
| Norma m²/për person | 8.46 m² | |

Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL , gjatë vizitës

Në lidhje me këtë standard u shfrytëzua RVB, vizita në terren përkatësisht në ambientet e departamentit të TI, për programin mësimor "Elektronike" u vizituan ambientet e sallave të leksionit përkatësisht nr.415, 414, 413 të pajisura me 32 tavolina, 66 karrige, 1 projektor të varur, 1PC përkatësisht secila prej tyre. U vizituan sallat e seminareve nr.404, 405, 406 te pajisur me tavolina për akomodimin e 40 studentëve. U vizitua Laboratori i Elektronikës nr.407, Laboratori i Informatikës i vendosur në katin e katërt, Laboratori i Fizikës nr.412, laboratorit e Elektronikës nr.408 dhe 409, laboratorit i Informatikës nr.411. Laboratorët janë të pajisur me mjetet dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e një praktike profesionale laboratorike. Çdo orë laboratorike zhvillohet për 12 studentë të ndarë në katër grupe. Gjatë vizitës u evidentua përdorimi i udhëzuesve laboratorike të cilët vihen në dispozicion të studentit përpara zhvillimit të orës laboratorike. Në zhvillimin e vizitës, u evidentua një staf akademik me eksperiencë mbi 20 vjet në fushën e elektronikës dhe zhvillimit të orëve laboratorike. Për studentët në vështirësi laboratorët qëndrojnë të hapur edhe ditën e Shtunë dhe të Djelë. Për rritjen e kapacitetit të studentëve për vitin akademik 2017-2018 mendohet të shfrytëzohet edhe godina tjetër në pronësi dhe zgjerim të laboratorëve. Mbështetja financiare është e garantuar nga institucioni për këtë zgjerim të infrastrukturës.

Reference: dok 14, dok.10, dok.15

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Kolegji Profesional i Tiranës është në pronësi të shoqërisë tregtare KPT shpk e themeluar sipas të drejtës shqiptare në datë 18 Shkurt 2015 me numër NIPT L5142003Q, e regjistruar në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Licensimit në 21 Shkurt 2015 me kohëzgjatje me afat të pacaktuar. Të qenurit një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e bën këtë institucion ti nenshtrohet të gjithë rregullave dhe legjislacionit shqiptar dhe është subjekt kontrolli nga MAS, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Ministria e Finances. Të ardhurat sigurohen nga tarifat e studentëve të cilat për vitin 2015 kanë qenë në masën 23% ndërsa për vitin 2016 në masën 100%, si edhe nga aktivitetet tregtare si bare, kafe etj të cilat për vitin 2015 kanë qenë në masën 77% ndërsa për vitin 2016 në masën 100%.

Pasqyrat financiare të KPT-së miratohen në mbledhjen e Asamblesë së Oërtakeve të KPT-së dhe depozitohen elektronikisht në Zyrën e Tatimeve dhe në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, duke siguruar një akses për çdokush të interesuar. KPT zotëron pasqyrat financiare për vitin financiar 2015 dhe 2016. Në bazë të Ligjit Nr. 10091 date 05.03.2009 "Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, KPT nuk i nënshtrohet procesit të auditimit.

KPT është institucion i Arsimit të Lartë Privat me vetfinancim. Burimet financiare, të paktën për 5 vitet e ardhshme ndahen në parësore që sigurohen nga ortakët e KPT-së në cilësinë e pronarit, në tarifat e shkollimit që konsiderohen si burime dytësore. Funkcionet administrative dhe financiare janë të sanksionuara në Statut dhe në Rregulloren e Institucionit. Funkcionet administrative, ekonomike dhe financiare realizohen nëpërmjet Kancelarit, zyrës së financës dhe Administratorit të KPT-së detyrat përkatëse të secilit janë të sanksionuara në Statut [dok. 6 neni 15, pika 1,2]. Të gjithë veprimet financiare mbahen në programin financiar Alpha [vizite ne

zyren e finances] i cili gjeneron raportet financiare për çdo student, raportin vjetor financiar, shpenzimet, të ardhurat dhe parashikimin për vitin financiar të ardhshëm. Hartimi i projekt buxhetit bëhet nga zyra e finances dhe Kancelari/Administratori i KPT-së duke u bazuar në kërkesat e bëra nga çdo departament si edhe nga pasqyrat financiare për realizimin e vitit akademik. Projekt Buxheti analizohet nga Administratori i cili përgatit një raport të hollësishëm për Asamblenë e Partnëreve. Zyra e financës është përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e tij pas marrjes së aprovimit përfundimtar.

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në vitet e fundit (plotëso Tabelën 5, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 5

| Të ardhurat (në lekë) nga: | Viti 1 | Viti 2 |
|---|-------------|-------------|
| Pushteti qendror | | |
| Pushteti vendor | | |
| Grantet për kërkim dhe kontratat | | |
| Konsulencat, shërbimet | | |
| Tarifat (regjistrim/shkollim/etj) | 23% | 100% |
| Sponsorizimet | | |
| Tarifat për trainim (kualifikimi i vazhdueshëm) | | |
| Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj | | |
| Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) | 77% | 100% |
| SHUMA | 100% | 100% |

- Shpenzimet për vitet e zhvillimit të programit sipas burimit të financimit**

Gjatë vitit akademik 2016 – 2017, ndjekin studimin për programin mësimor “Elektronikë” 55 studentë. Kosto për studentë është 195.680 lekë. Të dhënat e studentëve vit pas viti tregojnë një rritje të numrit të studentëve. Parashikohet një rritje të numrit të studentëve për këtë program në vitin akademik 2017-2018 në 500 studentë. KP ka një qëndrueshmëri financiare me qëllim zhvillimin normal të veprimtarisë akademike, në respektimin e ligjeve dhe akteve nënligjore dhe në përputhje me standardet e cilësisë. Investimet në infrastrukturë dhe mbështetja financiare jepet nga Asambleja e Partnërëve të këtij institucioni.

- Kosto e studimit/për student për një vit akademik**

Gjatë vitit akademik 2016 – 2017, ndjekin studimin për programin mësimor “Elektronikë” 55 studentë. Kosto për studenëe është 195.680 lekë.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL , gjatë vizitës**

Nuk ka dokumentacion të marrë gjatë vizites.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies KPT ka ngritur Njësisë e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila kryen punë të vazhdueshme për monitorimin e veprimtarisë së institucionit dhe sigurimin e cilësisë së brëndshme. Njësia është krijuar në 28 Dhjetor 2015 dhe përbëhet 6 anëtarë ku 4 janë staf akademik, një anëtar është student dhe 1 është ekspert i jashtëm. Funkzioni i NJSBC është sanksionuar në Statutin e KPT-së [dok 6 nëni 11, pika1] në Rregulloren e KPT- së [dok. 11 nëni 5, pika 1.1] dhe funksionon mbi bazën e një rrëgullore “Rregullore mbi Organizimin dhe Funksionimin e Njësisë së Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë në



Kolegjin Profesionale të Tiranës”. Aktiviteti i NJSBC zhvillohet mbi bazën e një plani vjetor në të cilën planifikohen kontrollat në bashkëpunim me shefin e departamentit të TI-së. Objekt kontrolli është mësimdhënia, mënyra e organizimit të mësimdhënies, mënyra e hartimit të syllabusit, mënyra e hartimit të tezës dhe vlerësimit të studentëve etj. Mbi bazën e këtyre kontrolleve periodike hartohen edhe raportet të cilat dërgohen drejtpërdrejt tek Rektori. Vlerësimi i mësimdhënies bëhet nga studentët përmes plotësimit të një pyetsori në hard copy, pyetsor i cili plotësohet pa praninë e pedagogut përkatës të lëndës që mërret në shqyrtim. Kontrolli për mësimdhënie bëhet përmes ngritjes së një grupi i përbërë nga Rektori, një anëtar i departamentit (kryesisht shefi i departamentit) dhe një anëtar i NJBSC. Mbi bazën e rezultateve të gjetura rekomandohen edhe ndryshimet. Nëse vlerësimi nuk është i mirë atëherë ndiqet edhe kontroll për orë surprizë tek pedagogu dhe nuk rinovohet kontrata e tij. Nuk ka patur raste të largimit të stafit për vlerësim jo të mirë.

Terma reference: Funkionimi i Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Tabela 6

| | Anëtarët e NJSBC | Detyra që ka në në NJSBC | Sa kohë ka në këtë detyrë |
|---|------------------|--------------------------|---------------------------|
| 1 | Antoneta DEDA | Anëtar | Dhjetor 2016 – në vazhdim |
| 2 | Ervin SULI | Anëtar | Dhjetor 2016 – në vazhdim |
| 3 | Teuta HALILAJ | Anëtar | Dhjetor 2016 – në vazhdim |
| 4 | Jola OSMENAJ | Anëtar | Dhjetor 2016 – në vazhdim |
| 5 | Samuel CURRAJ | Student | Dhjetor 2016 – në vazhdim |
| 6 | Odetta CATI | Ekspert i jashtëm | Dhjetor 2016 – në vazhdim |

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJBSC si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët e programit të studimit
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
- Etj

Anketimet për programin mësimor “Elektronikë” janë bërë për çdo pedagog që jep mësim në këtë program.

| NNr. | Lënda | Lektori | Numri Total i studentëve | Kampioni i kontrolluar |
|------|----------------------------------|--|--------------------------|------------------------|
| 11 | Administrim rrjeti | Prof. Asc. Elson Agastra | 18 | 15 |
| 22 | Bazat e Informatikës | Dr. Nevila Xoxa MsC. Leon Merja MSc. Hatixhe Bilibashi MSc. Andi Zeneli | 238 | 39 |
| 33 | Gjuhë angleze | MND Petro PLASA | 57 | 49 |
| 44 | Hyrje në teknologji informacioni | Dr. Ilia Shinko Dr. Renalda Kushe MSc. Andi Zeneli MSc. Erjon Curraj | 137 | 112 |



| | | | | |
|----|--|-------------------------|-----|----|
| 55 | Matematikë | Prof. Dr. Shpetim Bozdo | 273 | 33 |
| 66 | Makina Elektrike | MSc. Dritan Karriqi | 18 | 15 |
| 77 | Mikroprocessorët dhe mikrokontrollerët | MP Saimir Yzeiri | 18 | 16 |
| 88 | Radiourat dhe satellitët | Dr. Alban Rakipi | 18 | 15 |
| 99 | Qarqet elektronike të fuqisë | Prof. Dr. Piro Cipo | 18 | 15 |

Janë anketuar 18 studentë për programin mësimor “Elektronikë” për semestrin e dytë të vitit akademik 2016-2017 ndërsa për lëndët me formim të përgjithshëm si Fizikë e Përgjithshme, Matematikë janë anketuar të gjithë studentët në të gjithë programet ku ofrohen përkatësisht këto lëndë.

Janë përpunuar përkatësisht 15 ose 16 anketime. Bazuar në raportin e dhënë nga NJSBC [dok. 16] dhe bazuar në takimin e bërë me anëtarë të kësaj njësie evidentoj që problematika kryesore ka të bëjë me literaturën e paraqitur në syllabus ku mungon paraqitja e shtëpise botuese në literaturën e rekomanduar ndërsa dy kampione janë dhënë për vlerësimin individual në të ciat nuk evidentohej problematike [dok.16, faqja 15, 16].

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel programi studimi

Përgjegjësia për kontrollimin dhe menaxhimin e cilësisë së mësimdhënies për programin e studimit “Elektronikë” është e përgjegjësit të departamentit të TI dhe NJBSC. Kjo përgjegjësi sanksionohet në Statut dhe në Rregulloren e KPT-së. Kontrolli për mësimdhënie bëhet përmes ngritjes së një grupi i përbërë nga Rektori, një anëtar i departamentit (kryesisht shefi i departamentit) dhe një anëtar i NJBSC. Mbi bazën e rezultateve të gjetura rekomandohen edhe ndryshimet. Nëse vlerësimi nuk është i mirë atëherë ndiqet edhe kontroll për orë surprize tek pedagogu dhe nuk rinovohet kontrata e tij. Nuk ka patur raste të largimit të stafit për vlerësim jo të mirë.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Raporti i NJBSC

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Ndonëse në fillimet e para NJSBC jep ndihmesën e saj në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në të gjithë zërat e tij, në përmirësimin e kurrikulave dhe syllabuseve. Shembuj u evidantuan gjatë takimit me studentet dhe në raportin e NJSBC [dok.16].

Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme

Rezultatet e vlerësimeve janë subjekt përpunimi dhe shqyrtimi drejtpërdrejt nga Rektori i cili është përgjegjës për marrjen e masave në përmirësimin e problematikës së paraqitur.

Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL , gjatë vizitës

Nuk është marrë dokumentacion gjatë vizitës.

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Programi i studimit “Elektronikë” është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të këtij institucioni. Qëllimi kryesor është aftësimi profesional i studentëve sipas kërkesave të tregut të punës. Qëllimi kryesor i këtij programi synohet të arrihet përmes një ndërthurje të kuadrit teorik me atë praktik/laboratorik dhe praktikës



profesionale. Cilësia në mësimdhënia është arritur përmes angazhimit të një stafi akademik të kualifikuar, përmes zbatimit të kurrikulava të ndërtuar mbi një kuadër teorik bashkëkohor, përmes ofrimit të një baze të qartë laboratike të ofruar në mjediset e KPT-së ose në subjektet pritese sic është Universiteti Politeknik i Tiranës. Programi është i organizuar në module dhe i vlerësuar me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Kreditëve (ECTS). Ky program studimi ka një shtrirje dy-vjeçare akademike dhe në total ofron 120 kredite.

Organizimi i programit të studimit ofrohet në dy vite akademike ku çdo vit akademik ka dy semestra. Një semester ka 15 javë mësimore në auditor. 1 ECTS = 25 orë mësimore nëauditor. Emërtimi i diplomës për programin e studimit “Elektronikë” është “DIPLOME PROFESIONALE NË ELEKTRONIKË”.

Plani mësimor për programin e studimit (jepet në Aneks, plani mësimor që IAL ka paraqitur në RVB sipas Tabelës 7)

Tabela 7

| Viti I/(Viti II) | Lëndë/Module | Semestri | ECTS | Orë në javë | Orë mësimore | | | | | | | | | | | | | Orë në auditor | Punë e Pavarur | Gjithsej | Provime |
|------------------|---------------------------------------|----------|------|-------------|--------------|------------|--------------|----------|------------|--------------|-----------|------------|--------------|----------|------------|--------|----|----------------|----------------|----------|---------|
| | | | | | Leksione | | | Seminare | | | Laborator | | | Praktikë | | | | | | | |
| | | | | | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | Punë e | | | | | |
| 1 | Bazat e Informatikës | I | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 | | |
| 2 | Bazat teorike të qarqeve elektronike | I | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 | | |
| 3 | Fizikë e PËrgjithshme | I | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 | | |
| 4 | Hyrje në Teknologjinë e Informacionit | I | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 | | |
| 5 | Matematikë | I | 6 | 4.5 | 3 | 21 | 54 | 3 | 36 | 39 | | | | | | 57 | 93 | 150 | 2 | | |
| 6 | Anglisht | II | 5 | 3.5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | | | | | | 45 | 80 | 125 | 2 | | |
| 7 | Matje dhe Instrumenta elektronike | II | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 | | |
| 8 | Rjetat e kompjuterave | II | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 | | |
| 9 | Sisteme elektronike digitale | II | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 | | |
| 10 | Makinë elektrike | III | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 | | |
| 11 | Mikroprocesorët dhe mikrokontrollet | III | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 | | |
| 12 | Programim në JAVA | III | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 | | |
| 13 | Administrim Rrjeti | III | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 | | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|-----------------------------------|-----|------------|------------|-----------|------------|------------|-----------|------------|------------|-----------|------------|-----------|--|--|-------------|-------------|-------------|---|
| 14 | Qarqe të elektronikës së fuqisë | III | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 |
| 15 | Radiourat dhe satellitet | III | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 |
| 16 | Aplikime me sensorë | IV | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 |
| 17 | Plc dhe rrjetat me to | IV | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 |
| 18 | Sisteme operative | IV | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 |
| 19 | Praktika profesionale | IV | 7 | | | | | | | | 7 | 147 | 28 | | | 147 | 28 | 175 | 1 |
| 20 | Punimi i diplomës/ provim formimi | IV | 6 | | | | | | | | | | | | | 15 | 135 | 150 | 1 |
| | Totali | | 120 | 132 | 54 | 378 | 972 | 37 | 444 | 481 | 23 | 483 | 92 | | | 1320 | 1680 | 3000 | |

Kuadri i përgjithshëm formues i Programit të studimit (plotëso Tabelën 8, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 8

| Tipi i Veprimtarisë (A-F) | | Lënda/Moduli | Kreditet | Totali |
|--|---|---------------------------------------|----------|-----------|
| Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A) | 1 | Matematikë | 6 | 18 |
| | 2 | Fizike e Përgjithshme | 6 | |
| | 3 | Bazat Teorike të qarqeve elektronike | 6 | |
| Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B) | 1 | Radiourat dhe satellitet | 6 | 54 |
| | 2 | Matje dhe instrumente Elektronike | 6 | |
| | 3 | Sisteme elektronike analoge | 6 | |
| | 4 | Sisteme elektronike digitale | 6 | |
| | 5 | Makina elektrike | 6 | |
| | 6 | Plc dhe rrjetat me to | 6 | |
| | 7 | Aplikime me sensorë | 6 | |
| | 8 | Qarqe te elektronikës së fuqisë | 6 | |
| | 9 | Hyrje ne Teknologjinë e Informacionit | 6 | |
| Veprimtari në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C) | 1 | Mikroprocesorët dhe mikrokontrollerët | 6 | 18 |
| | 2 | Rrjetat e kompjuterave | 6 | |
| | 3 | Sisteme operative | 6 | |
| Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D) | 1 | Programim ne JAVA | 6 | 12 |
| | 2 | Administrim Rrjeti | 6 | |
| Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E) | 1 | Anglisht | 6 | 12 |
| | 2 | Bazat e Informatikës | 6 | |
| Provimi përfundimtar / Teza e punes studimore (F) | 1 | Tema/Provimi formimi | 6 | 6 |

Vleresimi i Syllabus-eve për çdo lëndë, ku duhet të pasqyrohen këto elementë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës



- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

U shqyrtuan të gjithë syllabuset të paraqitura në dok 17. Në total u administruan 20 syllabuse që mbulojnë disiplinën e formimit të përgjithshëm (A), disiplinën e formimit karakterizues të programit (B), disiplinën formuese të ngjashme integruese me disiplinat karakterizuese (C), disiplinën formuese të zgjedhura (D) dhe njohje të gjuhës së huaj, informatikë (E). Në shqyrtimin e tyre nuk u gjetën parregullsi dhe të gjitha i përmbaheshin në formë të detajuar formatit. Në syllabuse jepen të dhëna të qarta në lidhje me emërtesën e lëndës, pedagogun e lëndës, vendin që lënda që në formimin profesional të studentit. Raporti teori me praktikë dhe mënyra e vlerësimit shprehet qartë. Vlerësimi për ushtrime është 10 pikë, vlerësimi për punët laboratorike është 30 pikë dhe vlerësimi për provimin përfundimtar është 60 pikë. Gjatë takimit me stafin akademik u theksua nga ana e tyre që provimet e pjesshme të kryera gjate semestrit janë të ndërfutura në vlerësimin e ushtrimeve. Mendohet të bëhet një riorganizim për mënyrën e vlerësimit për vitin akademik 2017- 2018 në mënyrë që edhe vlerësimi i pjesshëm gjate semestrit të jetë i shprehur në të. Syllabuset janë funksion i një procesi përmirësimi të vazhdueshëm. Kërkesa vjen nga tregu i punes, avancimi i teknologjise, nga veti studentet si edhe nga eksperienca me shkolla të ngjashme. Janë bërë përmirësime në masën 20% të tyre.

Vlerësimi i Syllabus-eve nga ana cilësore

Nga ana cilësore syllabuset shprehin një vijueshmëri logjike të lëndëve. Merren konceptet bazë në lëndët e të gjithë disiplinave. Rekomandoj që disiplina të formimit karakterizues të programit dhe disiplina formuese të ngjashme integruese duhet të diferencohen kundrejt disiplinave të tjera duke konsideruar që përbëjnë bazën e formimit profesional të tyre. Ky diferencim të shprehet në kreditet dhe në shtimin e orëve teorike dhe laboratorike.

Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licensuara (plotëso Tabelën 9, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 9

| Viti I/Viti II Lëndë/Module | Semestri | ECTS | Orë në javë | Orë mësimore | | | | | | | | | | | | | | | Provine | |
|--------------------------------|---|------|-------------|--------------|------------|--------------|----------|------------|--------------|-----------|------------|--------------|----------|------------|----------------|----------------|----------------|----------|---------|---|
| | | | | Leksione | | | Seminare | | | Laborator | | | Praktikë | | | Orë në auditor | Punë e Pavarur | Gjithsej | | |
| | | | | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | Punë e Pavarur | | | | | |
| 1 | Teori qarqesh | I | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | | 66 | 84 | 150 | 1 |
| | U ndryshua ne: Bazat teorike të qarqeve elektronike | I | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | | 66 | 84 | 150 | 1 |
| 2 | Makina elektrike | III | 7 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | | 66 | 84 | 150 | 1 |
| | Makina elektrike u ndryshua në kredite | III | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | | 66 | 84 | 150 | 1 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--------------------|--|-----|---|---|---|----|----|---|----|----|---|-----|----|---|---|-----|----|-----|---|
| 3 | Vizatim teknik AutoCad | III | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 |
| | Lenda Vizatim teknik dhe AutoCad zëvendësohet me lënden: Radiourat dhe satellitet | III | 6 | 5 | 3 | 21 | 54 | 2 | 24 | 26 | 1 | 21 | 4 | | | 66 | 84 | 150 | 1 |
| 4 | Praktika Profesionale | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Praktika profesionale u ndryshua në kredite. Nga 6 kredite vlerësohet me 7 kredite | IV | 7 | | | | | | | | 7 | 147 | 28 | | | 147 | 28 | 175 | 1 |
| Ndryshime në total | | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |

Nuk ka ndryshime në total.

- Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (plotëso Tabelën 10, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 10

| Lënda /Moduli | | Pedagogu/Pedagogët përgjegjës | Titulli/grada kualifikimi | Departamenti ku është me kohë të plotë | Ngarkesa mësimore (orë) | Statusi PAE apo PAK |
|---------------|--------------------------------------|---|--|---|-------------------------|---------------------------------|
| 1. | Bazat Informatikës e | Nevila Xoxa Hatixhe Bilibashi Saimi Yzeiri | MSc; MSc; MP; | Teknologji Informacioni | 66 | PAK; PAK; PAE; |
| 2. | Bazat teorike të qarqeve elektronike | Piro Cipo Dratan Karriqi Thimi Oço Besnik Sedaj Saimir Yzeiri | Prof.Dr.; MSc; MSc; MSc; MP; | Teknologji Informacioni | 66 | PAE PAE PAE PAE PAE |
| 3. | Fizike Përgjithshme e | Antoneta Deda Teuta Halilaj Elfrida Topçiu | Prof.Dr; MSc; Dr; | Elektromekanik e dhe sisteme të aplikuara | 66 | PAE PAE PAK |
| 4 | Hyrje në Teknologjinë e Infomacionit | Ilir Shinko Renalda Kushe Andi Zeneli | Dr; Dr; MSc; | Teknologji Informacioni | 66 | PAK PAK PAK |
| 5 | Matematikë | Shpetim Bozdo Ervin Suli | Prof.Dr.; MSc; | Teknologji Informacioni | 57 | PAE PAE |
| 6 | Anglisht | Petro Plasa | MND | Teknologji Informacioni | 45 | PAE |
| 7 | Matje dhe instrumenta elektronike | Oirro Cipo Thimo Oço Besnik Sadaj | Prof.Dr.; MSc; MSc; | Teknologji Informacioni | 66 | PAE PAE PAE |
| 8 | Rrjetat kompjuterave e | Renalda Kushe Leon Merja | Dr.; MSc; | Teknologji Informacioni | 66 | PAK PAE |



| | | | | | | |
|----|---------------------------------------|--|---------------------------|----------------------------|----|-------------------|
| 9 | Sisteme elektronike analoge | Marsida Ibro Saimir Yzeiri Besnik Sadaj | MSc; MP; MSc; | Teknologji Informacioni | 66 | PAK PAE PAE |
| 10 | Sisteme elektronike digjitale | Luan Karçanaj Saimir Yzeiri Engjell Ciraku | Prof.Dr.; MP; MSc; | Teknologji Informacioni | 66 | PAE PAE PAE |
| 11 | Makina Elektrike | Dritan Karriqi | MSc; | Teknologji Informacioni | 66 | PAE |
| 12 | Mikroprocesorët dhe mikrokontrollerët | Saimir Yzeiri | MP | Teknologji Informacioni | 66 | pae |
| 13 | Administrim Rrjeti | Elson Agastra | Prof.Assoc.; | Teknologji Informacioni | 66 | PAK |
| 14 | Qarqe të elektronikës së fuqisë | Pirro Cipo; Engjell Ciraku; Besnik Sadaj; | Prof.Dr.; MSc; MSc; | Teknologji Informacioni | 66 | PAE PAE PAE |
| 15 | Radiourat dhe satellitët | Alban Rakipi | Dr.; | Teknologji Informacioni | 66 | PAK |
| 16 | Aplikime me sensorë | Viola Civici; Algert Islamaj; Saimir Yzeiri; | MSc.; MSc.; MP; | Teknologji Informacioni | 66 | PAK PAK PAE |
| 17 | Plc dhe rrjetat me to | Ilir Shinko; Leon Merja; | Dr.; MSc.; | Teknologji Informacioni | 66 | PAK PAE |
| 18 | Sisteme operative | Elson Agastra | Prof.Assoc. | Teknologji Informacioni | 66 | PAK |

Në zhvillimin e këtij program studimi janë të angazhuar 24 pedagogë si staf akademik ku 4 zotërojnë titullin Prof.Dr., 1 me titullin Prof.Assoc., 4 me gradën Dr., 1 pedagog me MND dhe 13 me MSc.; Raporti pedagogë/studentë është 1:2 ndërsa raporti pedagogë të brendshëm/studentë është 1:4.

Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës

Plani mësimor për vitin akademik 2016-2017;

Vlerësimi sipas standardeve:

| Standardi 6: Struktura e programit, rezultatet e të mësuarit dhe proceset e vlerësimit të mësimdhënies janë në përputhje me standardet evropiane. |
|--|
| <p>Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:</p> <p>Kriteri 1 Programi është në përputhje me Bolonjën, Përshkruesit e Dublinit dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.</p> <p>Kriteri 2 Studentët janë të pajisur me Suplementin e Diplomës që përputhet me rregulloret e BE-së për diplomim</p> <p>Kriteri 3 Arritjet në nivelin 4 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, lejojnë regjistrimin në këtë program studimi</p> <p>Kriteri 4 Studentëve të regjistruar me formim dhe njohuri të ndryshme nga prurjet e zakonshme (jo tradicionale) u ofrohet mbështetje e duhur që në fazat e hershme të programit.</p> <p>Kriteri 5 Programit ka 120 ECTS dhe lejon transferimin në vitin e 3, të një programi bachelor.</p> <p>Kriteri 6 Ka një raport të balancuar 50:50 praktikë / teori në programin mësimor, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve.</p> <p>Kriteri 7 Rreth 25% e programit është i vendosur në punë konkrete (p.sh. në një semestër ose i vendosur në pushimet e verës) ose në shkëmbime ndërkombëtare (p.sh. Erasmus +).</p> |



Kriteri 8 Mësimi praktik dhe elementëve të punës konkrete u është dhënë pesha e duhur në vlerësim dhe rivlerësim.

Vlerësimi sipas standardit 6:

Ndërtimi i programit dhe vendosja e sistemit të vlerësimit dhe kreditet për secilën kurrikul shpreh përputhshmërinë e këtij programi me Bolonjen dhe Kornizen Evropiane të Kualifikimeve. Ky program është në përputhshmëri me programet mësimore të shkollave simotra të të njëjtës natyrë.

Në përfundim të programeve të studimit dhe shlyerjen e të gjithë detyrimeve akademike dhe financiare studenti pajiset me diplomë profesionale me titullin Teknik i Lartë në fushën e arsimit të kryer përkatësisht "Elektronikë". Në përfundim të programit të studimit "Elektronikë" studenti pajiset me Kartonin e Diplomës, Supplementin e Diplomës dhe Listë Notash. Procesi i diplomimit është e sanksionuar edhe në Rregulloren e KPT-së [dok.11, kap.IX, neni 35].

Në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, KPT pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga institucione të tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, publike ose private dhe lejon transferime të studentëve të tij në institucione të tjera, nga programe studimi jouniversitare të natyrës profesionale. Modalitetet e kësaj procedure përcaktohen në Rregulloren e KPT-së.

KPT në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, kryen edhe njohje të krediteve duke mundësuar mobilitetin e studentëve nga një program studimi në tjetrin, brenda KPT-së, por pa cenuar rregullat e përcaktuara në pranimin e programit të studimit. Në çdo rast, studenti që transferon studimet nga një shkollë tjetër në KPT duhet të frekuentojë në KPT aq disiplina të programit sa të fitojë të paktën 60 kredite si edhe të shlyejë detyrimet e diplomit. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë studentët që transferohen nga institucione të huaja të arsimit të lartë, të vendeve të OECD-së, të cilat janë të njohura për standarte të larta të cilësisë. Në çdo rast studenti duhet të ndjekë në KPT, jo më pak se 25% të krediteve teorike, si edhe diplomën dhe praktikën profesionale. Në takimin me studentë u sollën dy shembuj të transferimeve nga universitet privat dhe nga universiteti Politeknik. Në të dy rastet studentët nuk kishin ndjekur procedurën e ekuivalentimit por kishin ndjekur edhe një here nga fillimi studimet për shkak të numrit të pakët të provimeve të dhëna [dok.11, kap.VII, neni 32].

KPT ka të shprehur qartë kriteret e pranimit të studenteve. Kjo është e shprehur në Rregulloren e KPT-së [dok. 11, kap.III, neni 9]. Përfundimi me sukses i provimeve të detyrueshme të Maturës Shtetërore dhe zotërimi i një diplome të shkollës së mesme të përgjithshme me kohëzgjatje tre vjet, ose sipas sistemit të vjetër me kohëzgjatje deri në tre vjet ose sipas sistemit të vjetër me kohezgjatje deri në katër vjet dhe të shkollës së mesme profesionale me kohëzgjatje me pesë vjet përbën kriter pranimi në KPT. Ky program ofron fleksibilitet në kriter pranimi edhe për ndonjë diplomë tjetër studimi të ndjekur në institucion jashtë vendit që njihet dhe ekuivalentohet sipas legjislacionit në fuqi. Fleksibilitet pranimi kanë edhe çdo kandidatë që zoteron një diplomë të marrë në arsimin e lartë dhe kërkon të ndjekë një program të dytë studimi dhe procesi i njohjes dhe vlerësimit të programit të studimit bëhet nga KPT në nivel departamenti. Rregullorja mësimore e programit të studimit të natyrës profesionale në "Elektronike" nuk parashikon specifikisht kritere pranimi për kandidatë të rregjistruar me formim dhe njohuri të ndryshme nga prurjet e zakonshme (jo tradicionale) dhe për pasojë nuk shpreh mbështjetjen e duhur të tyre që në fazat e hershme të programit.

Ka një raport të balancuar 50:50 praktikë / teori në programin mësimor, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve.

Rreth 43% e programit është e vendosur në punë konkrete në semestrin e dytë të vitit të dytë. Mësimi praktik dhe punës laboratorike u është dhënë pesha e duhur. Bazuar në programin mësimor rezultoi si vijon më poshtë:

Ngarkesa në orë në auditor

- | | |
|----------------------|---------|
| a) Leksione | 378 orë |
| b) Ushtrime / Detyra | 444 orë |



| | |
|---|---------|
| c) Laboratorë | 483 orë |
| d) Praktikë profesionale | 147 orë |
| e) Tema/Provim formimi | 15 orë |
| Konkluzionet e GVJ: | |
| Bazuar më sipër shpreh plotësisht mendimin e plotësimin të këtij standardi. | |

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësishë etj.

Programi i studimit “Elektronikë” ka të përcaktuar qartë format e mësimdhënies. Kjo është e shprehur në Rregulloren e KPT-së [dok.11, kreu V, neni 21, neni 23, neni 24]. Programi i studimit “Elektronikë” zhvillon kuadrin teorik, ushtrime, praktikën në laborator dhe praktikën profesionale. Kuadri teorik është i ndërtuar në formë të qartë dhe në nivel jouniversitar. Studenti merr koncepte bazë të cilat zhvillohen edhe në orë laboratorike. Evidentohet një përmirësim i kuadrit teorik në përputhje me kërkesat e studentëve [takim me studentet]. Pjesëmarrja në leksione është e detyrueshme në masën 60%.

Orët e ushtrimeve zhvillohen në përputhje me konceptet e marra në leksione. Pjesëmarrja në orët e ushtrimeve është e detyrueshme në masën 60%. Që në fillim të vitit studenti vihet në dijeni në lidhje me përmbajtjen e lëndës, detyrimet përkatëse në orët e leksioneve dhe ushtrimeve. Kjo është e shprehur edhe në syllabusin për secilën lëndë. Kuadri teorik gjen një konkretizim të qartë në orët laboratorike. Përmbajtja e tematikës në laborator është e shprehur në syllabus. Orët laboratorike zhvillohen me 12 studentë të ndarë në 4 grupe. Një ore tematike zhvillohet në 3 orë laboratorike. Zhvillimi i këtyre orëve bëhet në laboratorët e KPT-së ose në subjektet pritëse si Universiteti Politeknik i Tiranës. Drejtimi i orëve laboratorike bëhet nga një staf me eksperiencë në këtë fushë. Pjesëmarrja në orët laboratorike është e detyrueshme në masën 80% dhe për vitin e ardhshëm akademik synohet të bëhet 100%.

KPT ka të sanksionuar edhe tutoriatin. Kjo është e shprehur edhe në Rregulloren e KPT-së [dok.11, Kreu VIII, neni 34]. Tutoriati është një shërbim që i ofrohet studentëve të KPT-së dhe synon t’i ndihmojë ata të identifikojnë dhe të arrijnë qëllimet e tyre akademike, t’i mbështesë për të parandaluar ndërprerjen e studimeve, zgjatjen e tyre përtej kohëzgjatjes normale, si edhe t’i inkurajojë që të përfitojnë nga të gjitha mundësitë që ofrohen në KPT. Përveç kësaj ofrohet edhe Këshillimi Akademik që është një proces në funksion të studentëve, për të sqaruar çdo paqartësi ose për të trajtuar çdo vështirësi që mund të haset nga studentit për shlyerjen e detyrimeve në lëndët që ai frekuenton. Tutoriati dhe këshillimi akademik u gjet funksional në KPT për programin e studimit “Elektronikë”. Kjo vjen edhe për pasojë të numrit të vogël të studentëve duke krijuar një klimë mbështetje dhe bashkëpunimi me stafin akademik.

Praktika profesionale është e shprehur në Rregulloren e KPT-së. Studenti është i detyruar të zhvillojë 147 orë në subjektet pritëse. Studenti vihet në dijeni për detyrimet në lidhje me praktikën profesionale nga departamenti i TI.

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit, (plotëso Tabelën 11, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 11

| Programi i Studimit jouniversitar 2 vjeçar | |
|--|------------------------|
| Format e mësimdhënies | Orët totale në auditor |
| Leksione | 378 |
| Seminare | - |
| Ushtrime | 444 |



| | |
|-----------------------|------|
| Laborator | 336 |
| Praktikë lëndore | - |
| Praktikë profesionale | 147 |
| Në total | 1305 |

- Format e kontrollit të njohurive (plotëso Tabelën 12, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)**

Vlerësimi i studentit është i shprehur në Rregulloren e KPT-së [dok.11, Kreu V, neni 22]. Vlerësimi i përgatitjes së studentit është një proces që zhvillohet përgjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtem të cilat i gjeta të shprehur në çdo syllabus:

- Provimi përfundimtar (60%)
- Kolokiume/detyra kursi/ laboratorë (30%)
- Aktivizimi në ushtrime (10%)

Evidentova një kombinim dhe peshë të njëjtë të komponentëve në të gjithë lëndët e caktuara për programin mësimor “Elektronikë”. Rekomandoj që në varësi të lëndëve dhe specifikave të tyre të paraqitet edhe vlerësimi në testimet gjatë vitit.

Tabela 12

| Format e kontrollit të njohurive | Pjesa (në %) ndaj totalit |
|---|---------------------------|
| Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive | P.sh. 10% |
| Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale, etj) | 30% |
| Testimet gjatë vitit | - |
| Provimi përfundimtar | 60% |
| Në total | 100% |

- Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë (plotëso Tabelën 13, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)**

Tabela 13

| Aktiviteti shkencor i IAL | Numri i studentëve të aktivizuar |
|---|----------------------------------|
| Për projekte/praktika në rang Institucioni | 8 |
| Për punime individuale të pedagogëve | - |
| Për projekte /praktika në rang Departamenti | 10 |
| Për projekte në bashkëpunim me të tjerë | - |

- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës

Nuk ka dokumentacion të marre gjatë vizitës në KPT.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Kolegji Profesional i Tiranës ka në fokus të punës së tij marrëdhëniet me studentët. Kjo është e shprehur në dokumentat bazë të këtij institucioni si Statuti, Strategjia e Zhvillimit dhe Rregullorja e KPT-së. Qëllimi i punës së stafit akademik në programi e studimit “Elektronikë” është aftësimi profesional i studentëve në përputhje



me kërkesat e tregut të punës në Shqipëri dhe jashtë. Nga takimi me studentët u evidentua përmbushja e pritshmërisë së tyre në lidhje me këtë program studimi. Afati i studimeve në këtë program është 2 (dy) vjet ndërsa afati maksimal i përfundimit të studimeve është 4(katër) vjet [dok.11 Kreu III, neni 12].

Per vitin akademik 2017-2018 parashikohet një rritje e numrit të studentëve për këtë program i cili do të shoqërohet edhe me një rritje të infrastrukturës mësimore (shtimin e numrit të sallave për leksione, ushtrime dhe laboratorë).

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit të studentëve është e shprehur edhe në Rregulloren e KPT-së [dok 11, Kreu III, neni 10]. Pranimi i studentëve i nënshtrohet një procedure përzgjedhëse nën drejtimin e organit përgjegjës për organizimin dhe administrimin e programit të studimit duke u bazuar në kriteret e pranimit të KPT dhe në dokumentacionin e paraqitur nga aplikanti. Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të departamentit të TI për një mesim normal dhe brenda standarteve. Parimet, kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve shpallen dhe bëhen publike në faqen zyrtare të KPT-së (<http://kolegjiprofesional.edu.al>), në llogarite e rrjeteve sociale, në materialet e ndryshme promovuese, në takimet që zhvillohen në shkollat e mesme.

Në programin e studimit "Elektronikë" e ofruar në KPT, pranohen për t'u regjistruar shtetas shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë kushtet:

- a. Zotërojnë dëftesen e pjekurisë ose diplomën përkatëse të shoqëruar me çertifikatën e notave.
- b. Dorëzojnë dokumentet e nevojshme për lidhjen e kontratës me KPT
- c. Plotësojnë të gjitha kriteret e pranimit të përcaktuara nga organet drejtuese të KPT-së.
- d. Kryejnë pagimin e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose të plotë sipas kushteve dhe përcaktimit të kontratës përkatëse mes KPT-së dhe studentit.

Kushte specifike të pranimit të studentëve

- a. Shtetas shqiptarë që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit duhet të ndjekin procedurën e njohjes në MAS në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- b. Nëse për arsye objektive, në momentin e regjistrimit studenti e ka të pamundur të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, ai konsiderohet "i regjistruar me kusht". Në këtë rast për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, studentit i jepet një afat kohor deri përpara përfundimit të semestrit të parë të studimeve. Në të kundërt bëhet edhe ç' regjistrimi i tij.

Për vitin akademik 2016-2016 regjistrimi i studentëve është bërë individual. Dorëzimi i dokumentacionit origjinal nga studenti ka qenë i detyrueshëm. Për vitin akademik 2016-2017 pranimi i studentëve u bë përmes aplikimit elektronik në faqen zyrtare të matures shtetërore ku maturantët aplikojnë online me formular aplikimi për programet e studimit që ata kanë zgjedhur dhe me pas është Agjensia Kombëtare e Provimeve që komunikoi me KPT për listën përfundimtare të aplikanteve të cilët kishin përzgjedhur edhe programin e studimit "Elektronikë" në KPT. Për këte viti akademik (2016-2017) studenteve u është kërkuar kopje të noterizuar të dokumentave bazë [vizitë në sekretarinë mësimore].

Nga takimi në sekretarinë mësimore u bë verifikimi për studentin Dorjan Bello i përzgjedhur në mënyrë rastësore dhe u evidentuan dokumentat e mëposhtme:

- Letër anagzhimi
- Çertifikatë personale
- Diploma e shkollës së mesme
- Foto (4 copë)
- Kontrata me KPT-në



- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (plotëso Tabelën 14, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)**

Shpërndarja e studentëve sipas notës mesatare në hyrje të programit “Elektronikë” [RVB]

| Numri i studentëve | | |
|------------------------------|------------------------------|------------------------|
| Viti akademik 2015 – 2016 | Viti akademik 2016 – 2017 | Nota mesatare në hyrje |
| 13 | 26 | 5~6 |
| 3 | 5 | 6~7 |
| 2 | 4 | 7~8 |
| 1 | 2 | 8~9 |
| 0 | 0 | 9~10 |

Tabela 14

| Programi i studimit 2 vjeçar jouniversitar në “Elektronike” | Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë) | Nota Mesatare | Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse) | Nota Mesatare |
|---|--|---------------|---|---------------|
| 2015-2016 | 19 | 5.96 | N/A | N/A |
| 2016-2017 | 37 | 6.045 | N/A | N/A |
| Në total | 56 | 6.03 | N/A | N/A |

Shenim: Nga RVB dhe vizita në sekretarinë mësimore u evidentua 1 pezullim dhe 1 çregjistrim.

| Programi i studimit 2 vjeçar jouniversitar në “Elektronike” | Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë) | Pezullime | C’regjistrime | Transferime |
|---|--|-----------|---------------|-------------|
| 2015-2016 | 19 | 1 | 1 | - |
| 2016-2017 | 37 | 1 | 1 | - |

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Kolegji Profesional i Tiranës ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve. Mobiliteti i studentëve është i shprehur në Rregulloren e KPT-së [dok.11, kreu VII, neni 32]. KPT ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me tre IAL përkatësisht Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti “Aleksander Moisiu” Durrës, dhe Universiteti Evropian i Tiranës [dok.15]. Universiteti Politeknik i Tiranës shërben edhe për ofrimin e një stafi akademik me eksperiencë si edhe vë në shërbim të programit të studimit “Elektronikë” infrastrukturen laboratorike. Në lidhje me universitetet e huaja, shembull u soll bashkëpunimi me universitetin e Larisës për zhvillimin e kurrikulave, pajisjeve laboratorike dhe përgatitjen e udhëzuesve laboratorike. Duke konsideruar programin e studimit “Elektronikë” një program të ri, nuk kemi evidenca të një konkretizimi të shkëmbimit të studenteve dhe stafit akademik në kuadër të marrëveshjeve.

- Të dhëna për punësimin e studentëve (plotëso tabelën 15 vetëm në rastin e riakreditimit)

Tabela 15

| Periudha e të dhënave (psh. 2013-2015) | | | |
|--|----------------------------|--|---|
| Programi i studimit jouniversitar 2 vjeçar në "Elektronike" | Numri total të diplomuarve | Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën) | Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën) |
| | N/A | N/A | N/A |

- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës

Nuk ka dokumentacion te marre gjate vizites

Vlerësimi sipas standardeve:

Standardi 3: Qasja e studentëve në mësimdhënie është mbështetur përmes hartimit të programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

- Kriteri 1** Hartimi i Programit të studimit është mjaftueshëm fleksibël për të mundësuar që studimi të përshtatet me punësimin.
- Kriteri 2** Përvojat e studentëve të fituara nga puna e tyre e mëparshme, janë integruar në modulet dhe vlerësimin e studentëve.
- Kriteri 3** Përmbytja e Programit është aktuale dhe i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe/ose kërkesat për aftësitë/shprehjet nga punëdhënësit.
- Kriteri 4** Vlerësimi dhe feedback-u i studentëve është përdorur në mënyrë efektive, për të mbështetur studentët jo tradicionale dhe të mësuarit e nxënësve me performancë të ulët
- Kriteri 5** Mësimdhënia përfshin metoda të ndryshme pedagogjike që i përshtaten studentëve të ndryshëm, p.sh. të mësuarit në veprim, puna në ekip dhe të mësuarit në formë të pavarur.

Vlerësimi sipas standardit 3:

Programi i studimit në "Elektronikë" është i përshtatshëm me kërkesat e tregut të punës. Përmes këtij programi studenti fiton njohuritë bazë dhe krijon mundësi për specializime të mëtejshme. Shfrytëzimi i bazës laboratorike aftëson studentët në zbatimin e teorisë në praktikë dhe aftësimin profesional të tyre e cila përbën një kërkesë baze e shumë punëdhënësve. Ndërtimi i programit është bërë nga një staf i kualifikuar i cili mbart eksperiencë në fushën përkatëse. Stafi është i kualifikuar edhe në fushën e mësimdhënies duke ofruar një metodologji mësimdhënie dhe laboratorike e vlefshme për studentët. Programi është i ndërtuar në katër disiplina të rëndësishme. Në disiplinën e formimit baze (A) studenti do të aftësohet në marrjen e njohurive bazë në matematikë, fizikë e përgjithshme dhe në bazat teorike të qarqeve. Disiplina e formimit karakterizues (B) përmban 9 lëndë bazë përmes të cilës studenti fiton njohuri bazë dhe të rëndësishme në radiourat dhe satelitët, matje dhe instrumenta elektronikë, sisteme elektronike analoge dhe digitale, makinat elektrike, Plc dhe rrjetat me to, aplikime me sensorë, qarqe të elektronikës së fuqisë dhe hyrje në teknologjinë e informacionit. Më pas vijohet në zgjerimin e njohurive në disipline formuese të ngjashme (C) si mikroprocesorët dhe mikrokontrolërat, rrjetat e kompjuterave dhe sistemet operative dhe vijohet edhe me disiplinën formuese me zgjedhje (D) ku studentit i ofrohet njohuri në programim në JAVA dhe administrim rrjeti dhe si veprimtari formuese shërben gjuha angleze.

Përmes zhvillimit të punëve laboratorike studenti aftësohet të punojë në grup dhe përmes praktikës profesionale të vere në veprim njohuritë e fituara. Fokusi i veçantë në formimin profesional të studentëve përmes zhvillimit të punëve laboratorike dhe praktikës profesionale përbën një nga avantazhet konkurruese të këtij programi mësimor dhe ofron mundësi punësimi të studentëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Standardi 4: Rezultatet e të mësuarit komunikohen që nga pranimi i studentëve deri në diplomim dhe janë shqyrtuar dhe vlerësuar

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Informacioni për mundësitë e regjistrimeve është i qartë dhe i publikuar, si dhe i mbështetur me udhëzime ndihmuese të stafit.

Kriteri 2 Ekziston një praktikë efektive e punës në ekip, midis stafit të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe stafit të IAL.

Kriteri 3 Synimet e programit dhe rezultatet e të mësuarit për elementët praktikë dhe akademikë janë të qarta, të mbështetura nga publikimi i rezultateve të të mësuarit në nivel moduli

Kriteri 4 Monitorimi i bibliotekës dhe i burimeve të tjera të mësimdhënies dhe të të nxëniet është bërë rregullisht. Janë ndërmarrë rregullisht praktika specifike të punësimit dhe zhvillimi i aftësive.

Vlerësimi sipas standardit 4:

Kriteret e pranimit dhe të regjistrimit të studentëve për të ndjekur programin në “Elektronikë” janë të shprehura qartë në Rregulloren Mësimore të programit të studimit të natyres profesionale në KPT. Përveç kësaj në infrastrukturën ndihmëse mësimore është vendosur edhe ngritja e një zyre informacioni.

Ekziston një praktikë efektive e punës në ekip, midis stafit të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe stafit të IAL. Synimet e programit dhe rezultatet e të mësuarit për elementët praktikë dhe akademikë janë të qarta, të mbështetura nga publikimi i rezultateve të të mësuarit në nivel moduli dhe shprehen qarte në përcaktimin e krediteve për çdo lëndë, në sistemin e vlerësimit të dijeve, në zhvillimin e procedurës së provimit dhe shpalljes së rezultateve brenda dy jave nga data e zhvillimit të provimit përkatës. Ndërtimi i një biblioteke me kapacitet 40 persona, ku studentët kanë akses në bibliografinë elektronike dhe në trajtë fizike të librave mundëson marrjen e një informacioni të shpejtë dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm studimi për studentët.

Konkluzionet e GVJ:

Bazuar në evidencat e paraqitura, në RVB, takimet me stafin akademik dhe studentëve, vizitën në sekretarinë mësimore, në bibliotekë dhe në ambjentet mësimore dhe laboratorike evidentoj të përmbushur këtë standard.

10. Aktivitetet profesionale në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: aktivitetet e organizuara nga njësi, lidhja e njohurive me praktikën profesionale, vlerësime zyrtare të aktivitetit individual të studentëve ose në njësinë.

- Kolegji Profesional i Tiranës, Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit për programin mësimor “Elektronikë” i kushton një vëmendje të veçantë bashkëpunim të nivel rajonal dhe kombëtar. Vlen të përmendet në Marreveshjet e Bashkëpunim të nënshkruara me IAL si Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti “Aleksander Moisiu” Durrës etj ku vendoset një theks i veçantë për bashkëpunim në projekte dhe aktivitete në interes të palëve. Për këtë hidhen baza të shëndosha për bashkëpunime në fushën e elektronikës, projekte në lidhje me procesin akademik – mësimor, organizim i orëve të hapura, tavolina të rrumbullakëta, konferenca, vënie në dispozicion të ambjenteve/ mjeteve mësimore, laboratorike për zhvillim orësh mësimore, akses në biblioteke dhe punë kërkimore [dok. 18].
- Në lidhje me bashkëpunim me vende të huaja vlen të përmendet Memorandumi i Mirëkuptimit lidhur me Universitetin e Selanikut, school of Lifelong Learning. Aktivitetet e bashkëpunimit do të realizohen në fushën e arsimit dhe trajnimit profesional dhe kryesisht në ofrimin e shërbimeve si trajnim dhe këshillim profesional. Në mënyrë të veçantë në këtë Memorandum shprehet



shkëmbimi i informacionit midis dy sistemeve respektive arsimore dhe mobilitetin student/staf akademik [dok 19].

- Trajnime të stafit akademik të programit mësimor “Elektronukë” bërë nga Polytech përkatësisht në date 9-10-11.01.2017 [dok.23] në:
 - “Universal PLC Trainer and simulation” që shërben për lëndët: proceset industriale, Plc dhe rrjeta me to, Programim, Hyrje ne mekatronike, Pneumatika industriale dhe ku u trajnuan në këtë fushë laboratorike 3 anëtarë të stafit akademik;
 - “Analog & Digital Electronin Trainer” që shërben për lëndët: sisteme elektronike digjitale, sisteme elektronike analoge ku u trajnuan në këtë fushë laboratorike 3 anëtarë të stafit akademik;
- Inovation Club3d print Drone [dok. 21], ku objektivi kryesor i këtij projekti konsiston në promovimin dhe mbështetje për të siguruar një brez të rinj sipërmarrës, për të forcuar mundësitë e bashkëpunimit nëpërmjet ngritjes së rrjeteve dhe duke dhënë mbështetje në të gjithë fazat e zhvillimit dhe përgatitjes së idesë së biznesit. Në lidhje me studentet e deges “Elektronikë” ky projekt ka konsistuar në marrjen e koncepteve bazë në lidhje me novacionin, prezantimi i portalit te KPT www.kpt.edu.al si edhe integrimi në të i Microsoft Office 365 dhe Classter si edhe bërja e mundur e aksesimit të llogarive të studenëve për perdorimin e Office 365 dhe Classter;
- Pjesëmarrje në panairë siç është “Panairi Shqiptar i Studimit dhe Punesimit” organizuar në 28-30.09.2016 në Pallatin e Kongreseve [dok.22].

Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës

Nuk ka dokumentacion i marre gjate vizites

11. Bashkëpunimi kombëtar (dhe ndërkombëtar)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Bashkëpunimet e realizuara nga njësia kryesore me tregun e punës që lidhet me këtë program studimi, si në nivel rajonal ashtu edhe në nivel kombëtar/ ndërkombëtar. Përfitimet institucionale, në nivel program apo në nivel studentësh gjatë këtyre bashkëpunimeve.

Në nivel kombëtar KPT ka marrëveshje me subjekte të cilat operojnë në fushën e komunikimeve elektronike si Deutch Telecom, ABCOM etj. Për departamentin e TI aktualisht ka 7 marreveshje për zhvillimin e praktikave profesionale të cilët mundësojnë aftësimin profesional të studentëve.

| Nr. | Subjekti | Selia | Data e lidhjes së marrëveshjes | Afati | Fusha e aktivitetit | Kontakt |
|-----|----------------------|--------|--------------------------------|---------|-------------------------------|--|
| 1 | Tech 360 sh.p.k | Tiranë | 01.10.2016 | Pa fat | IT dhe elektronikë | erion.curraj@tech360.al |
| 2 | Telekom Albania sha | Tiranë | 27.01.2017 | Pa afat | Komunikime elektronike | |
| 3 | ABCom shpk | Tiranë | 01.02.2017 | Pa afat | Telekomunikacion | ceoasist@abcom.al |
| 4 | Qendra Protik | Tiranë | 30.02.2017 | Pa afat | Teknologjisë së Informacionit | info@protik.org |
| 5 | Albanian ICT Academy | Tiranë | 03.02.2017 | Pa afat | Teknologjisë së Informacionit | ibaniaictacademy@gmail.com |
| 6 | Elektro Servis | Tiranë | 01.04.2017 | Pa afat | Elektronikë | a.ajazi@elektroservis.al |
| 7 | Globe | Tiranë | 30.03.2017 | Pa afat | Elektronikë | info@globe.al |

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar (dhe ndërkombëtar) (plotëso Tabelën 16, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 16

| Aktivitete individuale ose në rang Institucioni, në kuadër të bashkëpunimit kombëtar në vitet e fundit | |
|--|--|
| 1 | Trajnim te stafit akademik dhe administrativ per sistemin classter nga Verti Tech S.A. |
| 2 | Seminar per studentet nga Qendra Protik mbi printimet 3D |
| 3 | Trajnim i stafit pedagogjik nga kompania Polytech |

Shpjegime:

- **KEK** – Korniza Europiane e Kualifikimeve (e cila ka 8 nivele)
- **KSHK** – Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (e cila ka 8 nivele) (aprovuar me Ligjin Nr.10 247, datë 4.3.2010 “PËR KORNIZËN SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE”)
- **AFP** - Arsimi dhe formimi Profesional (VET-Vocation Education Training)
- **CShAL** – Cikli i shkurtër i Arsimit të Lartë (anglisht: SCHE Short cycle of Higher education). Cikli i shkurtër i arsimit të lartë të (brenda ciklit të parë) është një program studimi profesional – 2 vjeçar, që mbulon 120 ECTS e para, të ciklit të parë. Në fund të tij lëshohet DPJ.
- **DPJ** – Diplomë Profesionale Jouniversitare (120 kredite, pas shkollës së mesme)
- **Niveli 4 KSHK** përshkruan kompetencat që duhet të arrihen nga studentët, dhe që duhet të ofrojë një bazë të shëndoshë **për hyrjen** në programet e arsimit të lartë profesional (dmth. për hyrjen në DPJ).
- **Niveli 5 KSHK** përshkruan kompetencat që duhet të arrihen nga studentët që pajisen me DPJ.
- **Neni 26, pika 4** “ Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të ofrojnë edhe programe të studimeve jouniversitare, profesionale, pas arsimit të mesëm, me jo më pak se 120 kredite. Kohëzgjatja normale e këtyre programeve është jo më pak se 2 vite akademike dhe në përfundim të tyre lëshohet “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer. Kreditet e akumuluar gjatë studimeve pas arsimit të mesëm mund të transferohen në studimet universitare të ciklit të parë, në përputhje me kriteret që vendosin institucionet e arsimit të lartë”

ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

RVJ për programin e studimit jouniversitar, professional, pas arsimit të mesëm, në Elektronikw, tw ofruar nga Kolegji Profesional I Tiranws, mbyllet me analizën përmbledhëse të RVJ, sipas metodës SWOT (*Strength* – pikat e forta, *Weakness* – pikat e dobëta, *Opportunities* – mundësitë, *Threats* – pengesat).

a. PIKAT E FORTA:

1. Kolegji profesional i Tiranës ka një strukturë solide menaxhimi.
2. Kolegji profesional i Tiranës ka një mbështetje të qëndrueshme financiare e cila garanton një vazhdimësi të programit të studimeve në “Elektronik”.
3. Kolegji profesional i Tiranës zotëron një infrastrukturë të duhur në përputhje me standartet e kërkuara për të garantuar një nivel mësimdhënie me cilësi të lartë.
4. Programi i studimit në “Elektronik” është në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
5. Stafi akademik në programin e studimit “Elektronik” është profesional dhe me një eksperiencë të gjerë.



6. Programet e programit në "Elektronikë" janë themeluar në bazë të standardeve evropiane dhe ato janë në koherencë me kërkesat e tregtisë së punës në Shqipëri.
7. Programi i studimit në elektronikë ofron një praktikë të gjerë laboratorësh që profesionalisht u mundëson studentëve në këtë fushë.
8. Kurset e programit në "Elektronikë" vlerësohen në bazë të Sistemit Evropian të Kreditimit dhe Akumulimit i njohur si ECTS.
9. Në programin e studimit për "Elektronikë" Marrëveshja e Mirëkuptimit me universitetet është një pikë e fuqishme në ofrimin studentëve dhe lektorëve për literaturat, hulumtimet shkencore dhe praktikat më të mira të huaja. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës dhe universitete të tjera jashtë vendit.
10. Student-pedagog i komunikimit interaktiv.
11. Struktura si Njësi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë rrit cilësinë dhe vazhdimësinë e programit mësimor.
12. Bashkëpunimi me kompanitë kombëtare.

b. DOBËSITË:

1. Nivel i ulët i studentëve.
2. Numer i vogël i studentëve të regjistruar.
3. Numër i kufizuar i librave për programin "Elektronikë" në bibliotekë.
4. Numër i madh stafi akademik me kohë të pjesshme (PAK).

c. MUNDËSITË:

1. Rritja e kapaciteteve të brendshme akademike përmes mbledhjes së eksperiencës më të mirë nga lektorët e jashtëm (AKP).
2. Shfrytëzimi akademik i kapaciteteve të personaliteteve të njohura në fushën e inxhinierisë elektronike, të punësuar aktualisht me kohë të plotë në Kolegjin Profesional të Tiranës.
3. Kontrolli i mbyllur i lakuar dhe vazhdimësia e përmirësimit drejt cilësisë së kurrikulës dhe mësimdhënies.
4. Transferimi i mobilitetit të studentëve nga universitete të tjera.

d. KËRCËNIMET:

1. Numër i kufizuar i studentëve
2. Mentaliteti i studentëve për të marrë një diplomë "Bachelor"

Eksperti i Vlerësimit të Jashtëm

1. Dr. Alketa GREPCKA

SWOT ANALYSIS

a. Strength point:

- 1) Profesional College of Tirana has a solid management structure.
- 2) Profesional College of Tirana has a sustain financial support which guarantee a continuity of the study programme in Electronic.
- 3) Profesional College of Tirana has a appropriate infrustructure in compliance with required standards for providing high quality level of teaching.
- 4) Study programme in Electronic is in compliance with labor trade demands.
- 5) The academic staff in study programme "Electronic" is professional and with wide experience.



- 6) The syllabuses of study programme in Electronic are established on the basis of the european standards and they are in coherence with labor trade demands in Albania.
- 7) The study programme in Electronic offers a wide laboratory'practices which professionally enable students in this fields.
- 8) The courses of the programme in Electronic are evaluated on the basis of European Credit and Accumulation System known as ECTS.
- 9) The Agreement of Understanding with universities is a strength point in altering the access of students and lectors for literatures, science researches and the best foreign practices. Cooperation Agreement with Polytechnic University of Tirana and other universities abroad.
- 10) Interactive communication student-pedagogue.
- 11) Structure as Unit for Internal Quality Assurance enhances the quality and continuity of teaching programme.
- 12) Cooperation with national companies.

b. Weakness points:

- 1) Low level of students.
- 2) Low number of registered students.
- 3) Limited number of books for Electronic programme in bibliotheque.
- 4) Large number of pedagogues with part-time contract (PAK).

c. Opportunities:

- 1) Increase the internal academic capacities through gathering the best experience from the external lectores (PAK).
- 2) The academic capacity exploitation of the well known personalities in the field of electronic engineering employed currently full time in Professional College of Tirana.
- 3) A closed loop control and continuity of improvement toward the quality of curricula and teaching.
- 4) Mobility transfer of students from other universities.

d. Threat:

1. Limited number of students
2. The mentality of students to obtain a Bachelor's degree

External evaluation group

1. Dr. Alketa GREPCKA



Aneksi I : PROGRAMI MESIMOR

Aneksi II (dokument plotësues i marrë në IAL)

Aneksi III (dokument plotësues i marrë në IAL)

SHTOJCA 1: Nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK - marrë nga Ligji Nr.10 247, datë 4.3.2010 “PËR KORNIZËN SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE”)

| | Arsimi i Përgjithshëm | Arsimi Profesional | Formimi Profesional | |
|---|--|--|---|----------|
| 8 | Doktoratë (Diplomë universitare për gradë shkencore) | Programe studimi / Kualifikim për specialist ekspert (Diplomë universitare për specializime apo kualifikime post master) | | 8 |
| 7 | Programe studimi Master (Diplomë universitare) | Programe studimi / Kualifikime e Specializime për menaxherë të lartë dhe për specialistë të lartë (Diplomë universitare profesionale për kualifikime apo specializime post Bachelor) | Kurse specializimi bazuar në kërkesa profesionale, përfitim ose përditësimi i njohurive të reja ose kompetencave më të gjera (Certifikatë Profesionale). | 7 |
| 6 | Programe studimi Bachelor (Diplomë universitare) | Programe studimi profesionale Bachelor Kualifikime për menaxherë dhe për specialistë (Diplomë universitare) | Kurse për menaxherë, specialistë dhe teknikë të lartë sipas niveleve të “Arsimit Profesional” (Certifikatë Profesionale) | 6 |
| 5 | Programe studimi deri në dy vjet pas arsimit të mesëm (Diplomë Profesionale) | Programe studimi deri në dy vjet pas arsimit të mesëm/Kualifikime për menaxherë të rinj dhe për teknikë të lartë deri në dy vjet pas arsimit të mesëm (Diplomë Profesionale) | | 5 |
| 4 | Matura e përgjithshme (Diplomë e Maturës Shtetërore) Programe studimi/Kurse kalimi (Dëftesë shkollore /certifikatë) Programe studimi/Kurse afatmesme (dëftesë shkollore 3) | Matura profesionale (Diplomë e Maturës Shtetërore) Programe studimi/ Kurse kalimi (Dëftesë shkollore / Certifikatë profesionale) Kualifikime për mbikëqyrës dhe për teknikë (Certifikatë) | Kurse kalimi (Certifikatë) Kurse specializimi bazuar në kërkesa profesionale, përfitim ose përditësimi i njohurive të reja ose kompetencave më të gjera (Certifikatë kompetencash dhe Certifikatë për mbikëqyrës dhe teknikë | 4 |
| 3 | Programe studimi deri dy vjet në arsimin e mesëm/ Kurse afatmesme (dëftesë shkollore 2) | Programe studimi/Trajnimi deri dy vjet për punëtor të kualifikuar (Dëftesa shkollore / Certifikatë profesionale) | Kurse për punëtor të kualifikuar (Certifikatë për punëtor të kualifikuar) | 3 |
| 2 | Programe studimi 1 vit në arsimin e mesëm / Kurse afatmesme (dëftesë shkollore 1) | Program studimi/trajnimi 1 vit, për ndihmës ose punëtor gjysmë të kualifikuar (Dëftesë shkollore / Certifikatë profesionale) | Kurse Formimi/Trajnimi për ndihmës dhe punëtor gjysmë të kualifikuar (Certifikatë për ndihmës ose punëtor gjysmë të kualifikuar) | 2 |
| 1 | KUALIFIKIMET MINIMALE PËR HYRJE NË PUNË OSE JETË SHOQËRORE (Dëftesë Lirimi) | | | 1 |

SHTOJCA 2

| | Njohuri | Aftësi | Kompetenca |
|-----------------|--|---|---|
| Niveli 1 | Njohuri bazë të përgjithshme | Aftësi bazë të nevojshme për kryerjen e detyrave të thjeshta | Të punuarit ose të studiuarit nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë brenda një kuadri të strukturuar |
| Niveli 2 | Njohuri bazë faktike për një fushë pune ose studimi | Aftësi bazë njohëse dhe praktike për përdorimin e informacionit përkatës, me qëllim kryerjen e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve rutinë, duke përdorur rregulla dhe mjete të thjeshta. | Të punuarit ose të studiuarit nën mbikëqyrje, me pavarësi të caktuar |
| Niveli 3 | Njohuri mbi faktet, parimet, proceset dhe konceptet e përgjithshme në një fushë pune ose studimi | Një sere aftësish njohëse dhe praktike që nevojiten për përmbushjen e detyrave dhe për zgjidhjen e problemeve nëpërmjet përzgjedhjes dhe për zbatimin e metodave, mjeteve, materialeve dhe informacionit bazë | Marrje e përgjegjësisë për kryerjen e detyrave në punë e studim. Përshtatje në rrethana të caktuara për zgjidhjen e problemeve |
| Niveli 4 | Njohuri teorike e faktike në një kontekst të gjerë në një fushë pune ose studimi | Një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur probleme të veçanta në një fushë pune ose studimi | Vetëmenaxhim brenda kuadrit udhëzues të punës ose studimit, i cili zakonisht është i parashikuar, por mund të ndryshohet. Mbikëqyrje e punës rutinë të tjerëve, duke marrë disa përgjegjësi për vlerësimin dhe përmirësimin e veprimtarive të punës ose studimit |
| Niveli 5 | Njohuri gjithëpërfshirëse të specializuara faktike dhe teorike brenda një fushe pune apo studimi deri në një nivel të caktuar | Një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet | Menaxhim dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive të punës ose studimit, në situata të ndryshueshme. Shqyrtimi dhe përmirësimi i performancës vetjake dhe të tjerëve |
| Niveli 6 | Njohuri të avancuara në një fushë pune apo studimi, duke përfshirë analizën kritike të teorive dhe parimeve | Aftësi të avancuara, që tregojnë mjeshtëri dhe inovacion, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë pune ose studimi | Menaxhim i veprimtarive ose projekteve komplekse teknike ose profesionale, duke marrë përgjegjësi për vendimmarrje në një situatë të paparashikuar pune apo studimi. Marrje përgjegjësi për menaxhimin dhe zhvillimin profesional të individëve apo të grupeve |
| Niveli 7 | Njohuri shumë të specializuara, disa prej të cilave në nivel të avancuar bashkëkohor në një fushë pune ose studimi, si bazë për mendim dhe kërkim origjinal. Analizë kritike e dijeve në një fushë ose në ndërveprimin e fushave të ndryshme | Aftësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve që nevojiten për kërkim dhe /ose inovacione, me qëllim që të zhvillojë njohuri dhe procedura të reja si dhe të integrojë njohuri nga fusha të ndryshme | Menaxhim dhe transformim i konteksteve të punës dhe studimit që janë komplekse, të paparashikueshme dhe që kërkojnë përqasje të reja strategjike. Marrje përgjegjësie për të kontribuar në njohuri ose praktikë profesionale dhe/ose për të rishikuar performancën strategjike të stafit/grupit. |



| | | | |
|------------------------|---|---|---|
| <p>Niveli 8</p> | <p>Njohuri në nivelin më të avancuar të një fushe pune apo studimi, si dhe në ndërveprimin ndërmjet fushave</p> | <p>Aftësi dhe teknika tepër të avancuara dhe të specializuara që përfshijnë sinteza dhe vlerësime të nevojshme për zgjidhjen e problemeve kritike në kërkim dhe/ose inovacion, si dhe zgjerimin dhe ripërcaktimin e njohurive ose praktikave profesionale ekzistuese.</p> | <p>Të demonstrojë autoritet të plotë, inovacion, pavarësi, integritet studimor dhe profesional, përkushtim të vazhdueshëm për të zhvilluar ide dhe procese të reja në kontekstin më të avancuar të punës ose studimit, përfshirë dhe kërkimin</p> |
|------------------------|---|---|---|